

Making Better Cities Together



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL - HANI I ELEZIT
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

JANAR 2011

PROPOZIM PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL - HANI I ELEZIT
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

JANAR 2011

Konsulentja e UN-Habitatit: Catarina Teles Ferreira Camarinhas

Ky raport është rezultat i një konsulence të pavarur të kryer për UN-Habitat Kosovo dhe nuk i paraqet domosdoshmëri qëndrimet dhe pikëpamjet e UN-Habitatit apo të Komunës së Hanit të Elezit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	4
PJESA I – KONTEKSTI MJEDISOR DHE I PLANIFIKIMIT	11
1. HYRJE	12
2. KORNIZA LIGJORE	12
3. KORNIZA TEORIKE	13
4. METODOLOGJIA E PROPOZUAR	14
5. PËRMBAJTJA DHE OBJEKTIVAT KRYESORE TË PZHKTË HANIT TË ELEZIT	16
6. PËRKUFIZIMI I FAKTORËVE KRITIK PËR PROCESIN E VENDIM-MARRJES	18
6.1. Tabela referuese strategjike	18
6.2. Çështjet mjedisore	21
PJESA II – VLERËSIMI MJEDISOR	24
7. GJENDJA E MJEDISIT	25
7.1. Cilësia e ajrit	25
7.2. Biodiversiteti	26
7.3. Faktorët klimatik	28
7.4. Trashëgimia kulturore	28
7.5. Menaxhimi i mbeturinave	29
7.6. Toka	29
7.7. Uji	31
7.8. Faktorët shoqëror dhe ekonomik	31
7.8.1. Demografia dhe shëndeti njerëzor	31
7.8.2. Zhurma	32
7.8.3. Banimi	33
7.8.4. Qasja - qasshmëria	33
7.8.5. Margjinalizimi shoqëror	34
7.8.6. Rekreacioni, sporti dhe koha e lirë	34
7.8.7. Sektori i arsimit	34
7.8.8. Veprimtaritë ekonomike	36
8. MOSPËRPUTHJA/MUNGESA E TË DHËNAVE	36
9. VLERËSIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME	37
9.1. Cilësia e ajrit	39
9.2. Biodiversiteti	39
9.3. Cilësia e ujit	39
9.4. Toka	39
9.5. Ndryshimet klimatike	39
9.6. Burimet natyrore	40
9.7. Trashëgimia	40
9.8. Shëndeti	40
9.9. Përfshirja dhe barazia shoqërore	40
9.10. Banimi	41
9.11. Margjinalizimi shoqëror	41
10. ZBUTJA DHE PËRMIRËSIMI	41
11. PAQARTËSITË DHE RREZIQET	45
12. MONITORIMI	46
13. PJESËMARRJA PUBLIKE DHE HAPAT E ARDHSHËM	48
14. FJALORTHI	49
15. LITERATURA	51



**Municipal Spatial Planning Support
Programme in Kosovo**



M a k i n g B e t t e r C i t i e s T o g e t h e r

Përmbledhje

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji nr.03/L - 230 i vitit 2010), thekson se vlerësimi strategjik mjedisor duhet të bëhet për Planet zhvillimore lokale. Duke qenë “një studim teorik që mëton të kontrollojë së dyti trajtimin e çështjeve mjedisore në nivelin strategjik dhe të projektit” (Bergerhoff 2010), VSM-të synojnë të ndihmojnë që planifikimin ta bëjnë më të qëndrueshëm.

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit e paraqet strategjinë themelore për zhvillimin e ardhshëm dhe për veprimet e mëtejme që duhet të ndërmerren, si dhe duhet t’i nënshtrohet vlerësimit strategjik mjedisor. Plani Zhvillimor Komunal është faza e parë për ta ofruar vizionin afatgjatë për zhvillimin e Hanit të Elezit. Ky raport sjell informata për procesin e deritanishëm të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Planit Zhvillimor Komunal; veçanërisht përcaktimin e një baze për vlerësim, problemet dhe mundësitë në Hanin e Elezit, vlerësimin e ndikimeve kritike që dalin nga ky propozim dhe propozimi i masave për zvogëlimin e ndikimit të efekteve të mundshme negative.

Çështjet kryesore të qëndrueshmërisë të cilat mendohet të jenë relevante për Hanin e Elezit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Çështjet kryesore mjedisore

FAKTORËT	ÇËSHTJET
Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> - Ndotja ekzistuese nga fabrika e çimentos; - Zhvillimi i mëtejme industrial mund të sjell më shumë ndotje; - Zhvillimi i mëtejme në Gorancë mund ta shtojë komunikacionin dhe ta përkeqësojë ndotjen e ajrit; - Transporti publik është i dobët.
Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> - Shpyllëzimi ilegal; - Shtimi i veprimtarive të shfrytëzimit të minierave, zhvillimi industrial dhe urban mund ta rrezikojnë edhe më shumë mjedisin natyror.
Faktorët klimatik	<ul style="list-style-type: none"> - Niveli i lartë i GS (Gazra të efektit të serës); - Blegtoria krijon nivel të lartë të GS.
Trashëgimia	<ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia vendore e lënë pas dore në rrezik; - Shqetësimi se zhvillimi i ri dhe përmirësimi i banimit mund ta rrezikojnë më tej trashëgiminë ekzistuese.
Menaxhimi i mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"> - Komuna nuk është e mbuluar tërësisht nga mbledhja e mbeturinave publike; - Deponitë ilegale të mbeturinave.
Toka	<ul style="list-style-type: none"> - Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave të ngurta; - Ekzistimi i mbetjeve helmuese kancerogjene të azbestit nga industria e azbestit dhe çimentos; - Kultivimi i blegtorisë është burim i madh i degradimit të tokës dhe ujit.
Uji	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesë e furnizimit me ujë të pijes; - Ndotja e ujit; - Zhvillimi i programuar urban, bujqësor dhe industrial do ta rrisë kërkesën për ujë.
Faktorët ekonomik dhe shoqëror	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesë e cilësisë së shërbimeve publike, kryesisht e objekteve sportive-rekreative, arsimore dhe shëndetësore; - Shkallë e lartë e papunësisë; - Nevoja për të përmirësuar cilësinë e gjithëmbarshme të banimit; - Shtimi i propozuar i banimit në Gorancë kërkon investime në transport dhe të tjera; - Rreziku e depopullimit; - Autostrada e re do ta rrisë ndotjen me zhurmë.

Objektivat për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit do të përdoren për të vlerësuar implikimet mjedisore, shoqërore dhe ekonomike të propozimeve dhe ato janë renditur më poshtë.

- Promovimi i zhvillimit kompakt, me një dendësi më të madhe në tokën ndërtimore dhe përmirësimi i shërbimeve shoqërore në zonat kryesore urbane;
- Identifikimi i strategjisë për shfrytëzimin efikas dhe efektiv të burimeve potenciale natyrore dhe shoqërore;
- Mbështetja e zhvillimit të ekuilibruar të zonave urbane dhe rurale;
- Identifikimi i rolit të zonave kryesore për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik;
- Identifikimi i prioritetëve për realizimin e projekteve;
- Përkufizimi i lokacioneve dhe resurseve potenciale për zhvillimin komunal;
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit;
- Drejtimi i përgatitjes së Planeve Urbane Rregulluese;
- Lehtësimi i shfrytëzimit dhe mbrojtjes së shfrytëzimit të shërbimeve industriale, biznesore dhe të banimit si dhe të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Identifikimi i projekteve potenciale për bashkëpunimin ndërkufitar.




Fig 1: Lokacioni i komunës, Hanit të Elezit

Shqyrtimi i planeve, programeve dhe objektivave kryesore përkatëse për mbrojtjen e mjedisit tregon se ekziston një koherencë ndërmjet planeve dhe programeve nga nivelet ndërkombëtare te ato vendase, si dhe ndërmjet sektorëve të ndryshëm, duke u bërë dëshmi e temave të vazhdueshme. Krahas politikave urbane tjera, janë shqyrtuar këto plane dhe programe: Agjenda 21 (Parimet për zhvillim të qëndrueshëm), Strategjia evropiane e biodiversitetit, Perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor, Ligji për planifikimin hapësinor në Kosovë, Ligji për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në Kosovë, dhe Plani hapësinor i Kosovës.

Në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor ne kemi menduar ta bëjmë vlerësimin e ndikimit të veprimeve të propozuara në çështjet kritike mjedisore. Kjo mund të ndihmojë në vlerësimin e efekteve të parashikuara të planit dhe të veprimeve të programuara të tij, si dhe të ndihmojë në përsosjen e planit duke i përdorur alternativat potenciale të zbatimit dhe duke i shqyrtuar masat për zbutje të ndonjë ndikimi negativ të identifikuar.

Vlerësimi është fokusuar në këto çështje mjedisore: cilësia e ajrit, biodiversiteti, cilësia e ujit, toka, ndryshimet klimatike (kryesisht emisioni i CO₂ dhe GS-ve tjera), burimet natyrore, trashëgimia, shëndeti, përfshirja dhe barazia shoqërore, banimi dhe marginalizimi shoqëror. Vlerësimi ka vënë në pah lidhjet dhe përplotësimet ekzistuese të forta ndërmjet qëllimeve të PZHK-së dhe të objektivave të shqyrtuara të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (çështjet mjedisore). Po ashtu, vlerësimi i ka përcaktuar përplasjet e mundshme ndërmjet veprimeve të propozuara në PZHK, të cilat mund të dalin nga aktivitetet e reja industriale, urbane, rurale dhe turistike.

Efektet kumulative të aktiviteteve të reja industriale dhe kushteve të reja për bartjen e mallrave parashihet që të kenë ndikim të rëndësishëm negativ në cilësinë e ajrit. Promovimi i një nën-qendre të re urbane në Gorancë mundet që, në afat të gjatë, ta shtojë varshmërinë nga veturat, si dhe të rezultojë me ndikime negative sekondare në cilësinë e ajrit. Megjithatë, ripyllëzimi i planifikuar (me kontrollimin e prerjes ilegale të drunjve) dhe krijimi i rripit të gjelbër për ta mbrojtur industrinë e çimentos, krahas krijimit të një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit, do të ndihmojë në ekuilibrimin dhe kontrollimin e këtyre ndikimeve negative. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, kryesisht duke i asfaltuar disa rrugë në komunë, po ashtu do të përmirësojë kushtet për udhëtimin me vetura, që do të sjell deri te efekti i mundshëm sekondar afatgjatë i dukurisë së zgjerimit/shtrirjes. Plani i parashikuar i transportit, duke përfshirë stacionin e ri të autobusëve, si dhe inkurajimi i modaliteteve të reja të transportit duke përfshirë trotualet dhe shtigjet për biçikleta do të kenë ndikim pozitiv në cilësinë e ajrit. Nëse fillojnë të zbatohen me racionalitet në faza të hershme të realizimit, ky sistem i transportit mund ta kontrollojë varshmërinë e panevojshme në vetura dhe dukurinë e zgjerimit.

Një sintezë e efekteve të rëndësishme që rezultojnë nga PZHK-ja e propozuar është paraqitur në Tabela 2.

Tabela 2: Sinteza e vlerësimit të efekteve të rëndësishme

NDIKIMET		
CILËSIA E AJRIT	+ deri ++	Ndikimet negative në cilësinë e ajrit mund të dalin nga aktivitetet e reja industriale nëse vazhdojnë trendët e tanishme si dhe nga zbatimi i kushteve të reja për transportin e mallrave. Promovimi i qendrës urbane sekondare në Gorancë dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore mund të sjellë deri te një rritje e nevojës për udhëtim me vetura. Megjithatë, PZHK-ja synon të sigurojë zbatimin e ligjit me çka do të minimizohet ndikimi i aktiviteteve industriale. Efektet pozitive të përgjithshme do të vijnë nga planifikimet për ripyllëzim, mbrojtjen e zonave pyjore, kontrollimin e shpyllëzimit ilegal, krijimit të rripit të gjelbër për ta mbrojtur industrinë e çimentos, plani për transport dhe miratimi i një sistemi për monitorimin e ajrit i cili do të sigurojë që të respektohen direktivat mjedisore.

BIODIVERSITETI	++	Efektet e panjohura në biodiversitet mund të paraqiten nga zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë. Por, pritet që këto efekte të mos jenë të rëndësishme për shkak të zonifikimit të tokës dhe shtimit të vogël të veprimeve të propozuara. Ndikimet pozitive do të vijnë nga mbrojtja e zonave pyjore, ripyllëzimit, përmirësimit të shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimca, veprimtaritë e dekontaminimit dhe nga zbatimi i masave ligjore për mbrojtjen e mjedisit.
CILËSIA E UJIT	++	Ndikimet negative mund të dalin nga aktivitetet e reja industriale nëse vazhdojnë trendët e tanishme. PZHK-ja synon të sigurojë zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit me çka do të minimizohet ndikimi i aktiviteteve industriale. Efektet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, dekontaminimit të lumit Lepenc nga azbesti, dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimca, zonifikimi i tokës dhe nga krijimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe impiantit të ujërave të zeza.
TOKA	- deri ++	Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtoria do të kenë ndikim negativ në mjedis. Ndikimet e rëndësishme pozitive do të vijnë nga regjenerimi i mjedisit, krijimit të një kompanie publike për menaxhimin e mbeturinave, zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimca, zonifikimi i tokës dhe nga krijimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe impiantit të ujërave të zeza.
NDRYSHIMET KLIMATIKE	- deri ++	Ndikimet negative mund të dalin nga aktivitetet e reja industriale dhe rurale nëse vazhdojnë trendët e tanishme, nga promovimi i qendrës urbane sekondare në Gorancë dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore mund të sjellë deri te një rritje e nevojës për udhëtim me vetura. Efektet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga planifikimet për ripyllëzim, mbrojtjen e zonave pyjore, kontrollimin e shpyllëzimit ilegal, zbatimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, krijimit të rripit të gjelbër për ta mbrojtur mjedisin urban nga industria e çimentos dhe autostrada, plani për transport dhe miratimi i një sistemi për monitorimin e ajrit.
BURIMET NATYRORE	- deri ++	Ndikimet e përgjithshme mund të vijnë nga zhvillimet e reja industriale, urbane dhe rurale, kryesisht nga rritja e kërkesave për ujë. Efektet pozitive të rëndësishme për sa i përket burimeve natyrore do të vijnë nga planifikimet për ripyllëzim, mbrojtjen e zonave pyjore, kontrollimin e shpyllëzimit ilegal, dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimca, krijimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, krijimi i impiantit të ujërave të zeza, zbatimit të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, zonifikimit të tokës dhe krijimit të një sistemi për monitorimin e ajrit dhe një kompanie publike për menaxhimin e mbeturinave.
TRASHËGIMIA	+ deri ++	Ndikimet negative në trashëgimi mund të dalin nga turizmi dhe zhvillimi i ri urban në Gorancë, për shkak të mungesës së inventarit të trashëgimisë dhe masave mbrojtëse. Ndikimet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga miratimi i planit për konservim dhe inventarizimit të trashëgimisë.
SHËNDETI	++	Ndikimet negative në shëndet mund të dalin nga aktivitetet e reja industriale nëse vazhdojnë trendët e tanishme. Megjithatë, PZHK-ja synon zbatimin e masave për të siguruar zbatimin e ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Efektet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga përmirësimi i objekteve shëndetësore, objekteve sportive, ripyllëzimi i planifikuar, mbrojtja e zonave pyjore, kontrollimi i shpyllëzimit ilegal, dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimca, krijimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, krijimi i impiantit të ujërave të zeza, krijimit të rripave të gjelbër, zonifikimi i tokës, planit për transport dhe nga krijimi i një sistemi për monitorimin e ajrit dhe një kompanie publike për menaxhimin e mbeturinave.
PËRFSHIRJA	+	Ndikimet shoqërore për sa i përket përfshirjes dhe barazisë mund të dalin

DHE BARAZIA SHOQËRORE		nga zhvillimi i ri urban në nën-qendrën Gorancë po që se nuk paraprihen me krijimin dhe përmirësimin e propozuar të shërbimeve dhe objekteve arsimore, shoqërore, shëndetësore dhe kulturore, si dhe zhvillimit të një sistemi të integruar të transportit publik.
BANIMI	++	Efektet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga krijimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe nga përmirësimet e rrjetit elektrik dhe banimit social.
MARGJINALIZIMI SHOQËROR	++	Efektet pozitive të rëndësishme do të vijnë nga krijimi i vendeve të punës në sektorët e industrisë, bujqësisë dhe turizmit, si dhe nga krijimi dhe përmirësimi i shërbimeve dhe objekteve arsimore, shoqërore, shëndetësore dhe kulturore, përmirësimeve në hapësirat publike dhe sistemin e transportit publik. Po ashtu, ndikimet pozitive sinergjike mund të vijnë nga bashkëpunimi ndërkufitar.

Kriteri i vlerësimit:

- ++** Opsion që inkurajohet aktivisht në formën aktuale të tij pasi që do të zgjidhte një çështje ekzistuese dhe/ose do të maksimizonte mundësitë.
- +** Opsion që do të kishte efekt neutral ose të paqartë
- Opsion që do të kishte ndikim negativ
- Opsion që duhet dekurajuar

PZHK-ja tashmë i propozon disa veprime për zbutjen e efekteve negative apo për rritjen e efekteve pozitive të zhvillimit njerëzor në mjedis. Tabela 3 bën sintezimin e masave kryesore të zbutjes dhe përmirësimit të cilat janë paraparë ose që duhet të futen në Planin Zhvillimor Komunal. Masat propozuara nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor janë paraqitur me ngjyra.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është detajzimi i mjeteve me anë të së cilave performanca mjedisore e një plani mund të vlerësohet duke propozuar një sistem monitorimi për zbatimin e planit. Sugjerohet që të miratohet një Instrument i Indikatorëve Global të Qytetit (GCIF), i cili është sistem i indikatorëve për të monitoruar performancën e qytetit i krijuar nga Universiteti i Torontos me përkrahjen e UN-Habitatit. GCIF është i ndarë në 22 kategori ku maten një varg i shërbimeve të qytetit dhe faktorët e kushteve jetësor. Kategoritë e shërbimeve të qytetit janë Arsimi, Energjia, Rekreacioni, Shërbimi Zjarrfikës, Qeverisja, Shëndetësia, Shërbimet Sociale, Mbeturinat, Transporti, Planifikimi urban, Ujërat e zeza, Uji. Kategoritë e kushteve të jetesës janë: Angazhimi qytetar, Kultura, Ekonomia, Mjedisi, Strehimi, Barazia sociale, Mirëqenia subjektive, Teknologjia dhe Inovacionet. Këta indikatorë janë përzgjedhur ashtu që të jenë “Në përgjithësi të disponueshëm, aktualë dhe në gjendje që të raportohen në baza vjetore; Të gatshëm për krahasim nëpër qytete; Relevante në vendim-marrjen për politikën publike; E lidhur me qëllimet e përcaktuara (p.sh. QZHK-të, master planet, infrastruktura, planifikimi i investimeve); Racional në mbledhjen e tyre; Domethënës për qytetet në tërë botën, pavarësisht gjeografisë, kulturës, begatisë, madhësisë apo strukturës politike; Fleksibil për përsosje dhe zgjerim me kalimin e kohës; Të kuptueshëm dhe jo shumë të ndërlikuar; dhe të Qartë lidhur me ndryshimet që i nënkupton indikatorin”.

Së fundmi, rregullat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor kërkojnë që organet konsultative, aktorët përkatës publik dhe të tjerë të ftohen për t’i shprehur mendimet e tyre për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe të ndihmojnë në sigurimin e identifikimit të gjitha çështjeve të rëndësishme mjedisore. Kësisoj, është përgatitur një pyetësor sipas standardeve dhe praktikave ndërkombëtare.

Tabela 3: Masat për zbutje

MAST PËR PENGIMIN E EFFEKTEVE NEGATIVE	
CILËSIA E AJRIT	Zbatimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor për aktivitetet industriale. Ripyllëzimi. Rripat e gjelbër (tampon) përgjatë autostradës dhe komplekseve industriale. Aprovimi i teknologjive për shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë së ripërtërishme

	<p>dhe promovimi i efikasitetit më të madh energjetik. Automjetet me emision të ulët në transportin publik. Hartimi i udhëzimeve për menaxhimin e pyjeve. Prioritetizimi i realizimit ashtu që të promovohet sistemi i transportit publik përpara zhvillimeve të reja.</p>
BIODIVERSITETI	<p>Ripyllëzimi. Rigjallërimi i bujqësisë (me izolimin e karbonit). Identifikimi i qyteteve me biodiversitete. Hartimi i udhëzimeve për menaxhimin e pyjeve. Sistemi i monitorimit të faunës dhe florës.</p>
CILËSIA E UJIT	<p>Zbatimi i VNM-së për aktivitetet e reja industriale. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin industrial.</p>
TOKA	<p>Bujqësia organike e qëndrueshme. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse.</p>
NDRYSHIMET KLIMATIKE	<p>Zbatimi i VNM-së për aktivitetet e reja industriale. Rripat e gjelbër (tampon) përgjatë autostradës dhe komplekseve industriale. Ripyllëzimi. Plani i transportit. Sistemi i monitorimit të ajrit. Teknologjitë e gjelbra, shfrytëzimi dhe prodhimi i energjisë së ripërtërishme, efikasitet më i madh energjetik. Rigjallërimi i bujqësisë (e cila mundëson izolimin e karbonit). Automjetet me emision të ulët në transportin publik. Hartimi i udhëzimeve për menaxhimin e pyjeve. Partneritetet inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin industrial.</p>
BURIMET NATYRORE	<p>Zbatimi i EIA për aktivitetet e reja industriale (me promovimin e CCS). Masat për mbrojtjen dhe regjenerimin e mjedisit. Plani i transportit. Sistemi i monitorimit të ajrit. Teknologjitë e gjelbra, shfrytëzimi dhe prodhimi i energjisë së ripërtërishme, efikasitet më i madh energjetik. Promovimi i rigjallërimit të bujqësisë (izolimi i karbonit). Automjetet me emision të ulët në transportin publik. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin industrial.</p>
TRASHËGIMIA	<p>Plani për konservim. Inventarizimi i trashëgimisë. Prioritetizimi i veprimeve strategjike, duke siguruar që Plani për konservim dhe inventarizimi i trashëgimisë të finalizohen përpara zhvillimeve të programuara urbane dhe turistike. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse.</p>
SHËNDETI	<p>Zbatimi i EIA për aktivitetet e reja industriale. Rripat e gjelbër (tampon) përgjatë autostradës dhe komplekseve industriale. Masat për mbrojtjen dhe regjenerimin e mjedisit. Plani i transportit. Sistemi i monitorimit të ajrit. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin industrial.</p>
PËRFSHIRJA DHE BARAZIA SHOQËRORE	<p>Prioritetizimi i veprimeve strategjike, duke ndërmarrë masa për të siguruar që zhvillimi publik t'i paraprijë investimeve private në banim dhe se mundësitë e financimit të këtyre veprimeve të gjinden në një fazë të hershme të këtij procesi.</p>

Konkluzionet kryesore

Modeli urban i propozuar nga projekt Plani Zhvillimor Komunal për Hanin e Elezit është rezultat i një procesi që është duke u zhvilluar prej vitit 2008, ku përfshihen autoritetet shtetërore dhe lokale me përkrahjen e Programit për Planifikim Hapësinor Komunal të UN-Habitatit në Kosovë, të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim në Zhvillimin Ndërkombëtar. Gjatë këtij procesi (në tetor 2010) është miratuar Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, duke hapur mundësinë e testimit të mundësisë së vlerësimit të qëndrueshmërisë së opsioneve të planifikimit të bëra në nivelin lokal. Disa opsione tashmë ishin vlerësuar gjatë procesit të planifikimit në takimet dhe seminarët për diskutime publike dhe në përkrahje të vendimit për miratimin e zgjidhjeve të paraqitura në Planin Zhvillimor Komunal për Hanin e Elezit. Vlerësimet e qëndrueshmërisë janë bërë gjatë procesit të planifikimit dhe përpara miratimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor i bërë për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit tregon se ekzistojnë nivele të ndryshme të ndikimeve mjedisore që i shkaktohen këtyre çështjeve mjedisore:

- Tokës; me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë shkaktohet ndikim i mundshëm negativ në mjedis për të cilën gjë janë sugjeruar masat zbutëse;
- Ndryshimet klimatike (kryesisht CO2 dhe emisioni i GS-ve tjera që dalin nga rritja e zhvillimit industrial dhe urban, përmirësimi të infrastrukturës rrugore dhe zhvillimit të blegtorisë),
- Burimet natyrore, me ndikime të mundshme nga zhvillimet e reja industriale, rurale dhe urbane, kryesisht nga rritje e kërkesave për ujë.

Në anën tjetër, ekzistojnë efekte pozitive të rëndësishme që dalin nga zbatimi i plotë i Planit Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit në të gjithë sektorët mjedisor, që kryesisht dalin nga mbrojtja dhe rigjallërimi i zonave pyjore, nëpërmjet ripyllëzimit, përmirësimi të shtratit të lumit Lepenc dhe të përroskës Dimca, aktiviteteve të dekontaminimit, krijimit të sistemeve për menaxhimin e kanalizimit dhe mbeturinave, nga zbatimi i masave të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe nga miratimi i një sistemi për monitorimin e ajrit. Ndikime pozitive të rëndësishme në trashëgimi priten të dalin nga plani për konservim dhe inventarizim të trashëgimisë. Në nivelin shoqëror, veprimet e propozuara në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe krijimit të vendeve të punës në sektorë të ndryshëm paraqesin mundësi të rëndësishme për Komunën.

Ndikimet ndërkufitare të planit janë më pozitive, pasi që masat e parapara për të mbrojtur dhe rigjallëruar mjedisin natyror do të kenë ndikime pozitive të rëndësishme në territoret kufitare, veçanërisht në cilësinë e ajrit dhe të ujit nga dekontaminimi dhe krijimi i impiantit për ujërat e zeza dhe zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit. Nuk janë paraparë ndikime negative në komunitetet fqinje; të gjitha aktivitetet industriale janë duke u paraprirë nga Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor që e zbaton mbrojtjen e mjedisit dhe që kërkon një Pëlqim mjedisor të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Prandaj, ekziston një ekuilibër tejet pozitiv i ndikimeve, të favorshme për miratimin e Planit, që janë futur në Planin Hapësinor të Kosovës dhe që i integrojnë masat e propozuara për minimizimin e ndikimeve negative.

Ne besojmë se ky është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ekuilibruar të hanit të Elezit, marrë parasysh objektivat dhe gjendjen aktuale të komunës, me synim mbrojtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe të biodiversitetit, ndërsa ofrohen mundësi për zhvillimin shoqëror.

Gjatë zbatimit të Planit, do të jetë e duhur që të kanalizohen fondet dhe të fuqizohen autoritetet lokale, të ndërtohen masat për zvogëlimin e ndikimit të katastrofave të ardhshme në pylltari, të sigurohet që edhe resurset të kanalizohen drejt shërbimeve që e avancojnë zhvillimin njerëzor, të sigurohet që, aktivitetet industriale ekzistuese dhe të parapara t'i respektojnë rekomandimet mjedisore dhe të marrin pjesë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Hapa të rëndësishëm për ta siguruar zbatimin e plotë të planit dhe për t'i shmangur efektet anësore të padëshiruara janë kapaciteti për të ndërtuar partneritete sinergjike me sektorët e tërthortë dhe me komunitetet ndërkufitare, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i prioritetëve të veprimeve të parapara në Planin Zhvillimor Komunal.

PJESA I – KONTEKSTI MJEDISOR DHE I PLANIFIKIMIT

1. Hyrje

Ky dokument e përbën raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (në tekstin e mëtejshëm: VSM), vlerësimin e faktorëve kritik mjedisor që e mbështesin procesin e vendim-marrjes të Planit Zhvillimor Komunal për komunën e Hanit të Elezit. Objektivi kryesor i VSM-së është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm duke i shqyrtuar hollësisht çështjet lidhur me qëndrueshmërinë të integruara në përgatitjen dhe miratimin e planeve. Synimi është që të krijohet një mendësi e qëndrueshmërisë përgjatë të gjitha etapave të planifikimit të zhvillimit, duke pasur parasysh se “efikasiteti i urbanizmit duhet t’i paraprijë koston së teknologjive alternative” (Calthorpe 2010: 15), duke u fokusuar në mbrojtjen e aspekteve kritike të mjedisit dhe në të njëjtën kohë të zvogëlohen kërkesat e përgjithshme për resurse.

UN-Habitati po e mbështet komunën e Hanit të Elezit në zhvillimin e aktiviteteve të planifikimit komunal dhe e ka emëruar një konsulent të pavarur për të ndihmuar në realizimin e VSM-së për Planin Zhvillimor të Hanit të Elezit. Fushëveprimi i VSM-së përfshin këto të arritura: Propozimi i metodologjisë për realizimin e vlerësimit të ndikimit në kontekstin e Kosovës; hartimin e konkluzioneve preliminare dhe projekt versionin e Raportit (Vlerësim i Qëndrueshmërisë dhe Raporti Shkoqitës, të prezantuar në dhjetor 2010); Versioni përfundimtar i Raportit ku përfshihen të gjitha kontributet e zyrtarëve të OKB-së, ekipit të Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal dhe të burimeve tjera. VSM-ja aktuale për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit është realizuar gjatë muajve dhjetor 2010 dhe janar 2011 dhe ka qenë e integruar me ekipin e PZHK-së në komunën e Hanit të Elezit.

2. Korniza ligjore

Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është një hap i rëndësishëm në ligjin mjedisor evropian. Direktivat evropiane n° 2001/42/EC për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedisin, të njohura si Vlerësimi Strategjik Mjedisor ose Direktiva VSM, dhe 2003/35/EC, lidhur me pjesëmarrjen e publikut në planet dhe programet e caktuara që kanë të bëjnë me mjedisin, e kanë krijuar Vlerësimin Strategjik Mjedisor për planet dhe programet në sektorët e bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionin, turizmin, planifikimin urban dhe hapësinor ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat e japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm, ku planifikimi komunal është i përkufizuar qartë.

Sipas pikës n.º 2 të nenit 3, kreu II, i Ligjit të Kosovës Nr. 03/L –230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (tetor 2010), “Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Ligji 03/L–230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor i përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtejshëm VSM) përmes integritit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, përcakton se VSM duhet të raportojë për këto aspekte:

1. një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe marrëdhënieve me plane ose programe të tjera;
2. aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit zhvillimi i ngjashëm për zbatimin e planit ose programit;

3. karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm;
4. problemet ekzistuese mjedisore që lidhen me planin ose programin, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si për shembull zonat e projektuara sipas Direktivave 79/409/EEC dhe 92/43/EEC;
5. objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, nivel Komuniteti ose Shteti Anëtar, të cilat lidhen me planin ose programin dhe mënyra në të cilën këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve;
6. efektet më të rëndësishme të mundshme mbi mjedis (duke përfshirë efektet dytësore, kumulative, sinergjike, afat shkurtë, mesëm dhe të gjatë, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative dhe sipas nevojës efektet ndërkufitare), duke përfshirë dhe çështje të tjera si biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen ndërmjet faktorëve të mësipërm;
7. masat e parashikuara për të shmangur, ulur dhe për të zhdukur sa më shumë të jetë e mundur efektet domethënëse negative në mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit;
8. një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përshkrim të mënyrës sesi u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë (si për shembull mangësitë teknike ose mungesa e njohurive teknike) të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar;
9. një përshkrim të masave të parashikuara për monitorimin, sipas nenit [...] të këtij ligji;
10. një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë nën kategoritë e mësipërme.

Vlerësimi Strategjik Mjedor i PZHK-së të Hanit të Elezit është realizuar Brenda kësaj kornize ligjore.

3. Korniza teorike

VSM është një instrument vlerësimi për vlerësimin e ndikimeve të natyrës strategjike (Partidário 2007), që synon që të:

1. Sigurojë një vizion dhe perspektivë të gjerë strategjike lidhur me aspektet mjedisore, në kuadër të qasjes për zhvillim të qëndrueshëm;
2. Sigurojë integrimin e aspekteve të lidhura me mjedisin në procesin e vendim-marrjes, deri sa opsionet për zhvillimin e ardhshëm janë në diskutim;
3. Ofrojë ndihmë në identifikimin, përzgjedhjen dhe arsyetimin e opsioneve kundruall sfidave mjedisore dhe synimeve zhvillimore;
4. Hetojë problemet dhe mundësitë, dhe paraqitjen e sugjerimeve për programet e menaxhimit dhe të monitorimit strategjik;
5. Sigurojë transparencë dhe pjesëmarrje në zhvillimin strategjik, duke i përfshirët gjithë aktorët përkatës;
6. Krijojë kontekstet për zhvillim që mund të jenë më adekuate për propozimet për zhvillimin e ardhshëm.

Deri sa qasjet e ndryshme metodologjike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor lejojnë që mundësi të ndryshme të ndikojnë në vendimet strategjike, Asociacioni Ndërkombëtar për Vlerësimin e Ndikimit (IAIA 2002) thekson se procesi VSM duhet t'i paraqesë kriteret e mëposhtme të performancës:

- Të jetë integruar (duke siguruar një vlerësim të duhur mjedisor për të gjitha vendimet strategjike relevante për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm; duke adresuar marrëdhëniet e brendshme të aspekteve biofizike, shoqërore dhe ekonomike dhe duke shqyrtuar politikat në sektorët përkatës dhe rajonet ndërkufitare);
- Të jetë i udhëhequr nga qëndrueshmëria, duke lehtësuar identifikimin e opsioneve zhvillimore dhe propozimeve alternative që janë më të qëndrueshme.
- Të jetë i fokusuar, duke ofruar informata të mjaftueshme, të besueshme dhe të përdorshme për planifikimin e zhvillimit dhe për vendim-marrje, duke u përqendruar në çështjet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm, i adaptuar ndaj rrethanave të procesit të vendim-marrjes dhe të jetë racional në kosto dhe kohë.;
- Të jetë llogaridhënës (duke qenë përgjegjësi e agjencive kryesore për marrjen e vendimeve strategjike, duke u realizuar me profesionalizëm, rreptësi, drejtësi, paanësi dhe barazi, duke iu nënshtruar kontrolleve dhe verifikimit të pavarur, duke dokumentuar dhe arsyetuar se si janë adresuar çështjet e qëndrueshmërisë gjatë vendim-marrjes).
- Të jetë pjesëmarrës, informues dhe që angazhon publikun dhe organet qeveritare të interesuara dhe të ndikuara gjatë tërë procesit të vendim-marrjes, duke i adresuar kontributet dhe shqetësimet e tyre në dokumentim dhe vendim-marrje, duke plotësuar kërkesat për informata të qarta dhe të kuptueshme lehtë dhe duke siguruar qasje të mjaftueshme në të gjitha informatat përkatëse.
- Të jetë përsëritës, duke siguruar disponueshmërinë e rezultateve të vlerësimit mjaft herët për të ndikuar në procesin e vendim-marrjes dhe për të frymëzuar planifikimin e ardhshëm, duke ofruar informata të mjaftueshme për ndikimet aktuale të zbatimit të vendimeve strategjike, për të vlerësuar nëse këto vendime janë ndryshuar dhe të ofrohet baza për vendimet e ardhshme.

Në procesin e planifikimit hapësinor, vendimet strategjike duhet të merren me kohë. Nëse VSM synon që të ndikojë në vendimet strategjike, ai duhet të jetë gjithashtu një proces i vazhdueshëm, i promovuar në kuadër të procesit të planifikimit, duke i integruar aspektet mjedisore dhe çështjet e qëndrueshmërisë gjatë krijimit të opsioneve strategjike për zhvillimin e ardhshëm.

4. Metodologjia e propozuar

Në këtë vlerësim ne do ta zbatojmë metodologjinë e propozuar nga Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal të UN-Habitatit në Kosovë (Bergerhoff 2010). Për elaborimin e VSM-së për propozimin e Planit Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit, ne gjithashtu i kemi marrë parasysh edhe *Direktivën për zbatim të Komisionit Evropian 2001/42/EC për Vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuar në mjedis* (EC 2003), *Udhëzues praktik për Direktivën për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Directive*, (ODPM 2005) dhe *Guia de boas práticas para a Avaliação Ambiental Estratégica* (Agência Portuguesa do Ambiente 2007).

Sipas Qendrës Mjedisore Rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore, metodat për identifikimin e ndikimeve mjedisore mund të përbëhen nga lista kontrolluese, matrica, analiza të rrjeteve, skicat dhe Sistemet Informative Gjeografike (GIS), sistemet e ekspertëve dhe/ose mendimet profesionale. Kriteret për zgjedhjen e metodës për VNM-të duhet të bazohen në llojin dhe madhësinë e propozimit, llojet e alternativave në shqyrtim, natyrën dhe shkallën e ndikimeve të mundshme, disponueshmërinë e metodave për identifikimin e ndikimit, përvojën e ekipit të VNM-së dhe burimet në dispozicion (shpenzimet, informatat, koha, personeli) (REC 2003).

Qasja e shfrytëzuar për hartimin e këtij raporti i është përmbajtur rekomandimeve ndërkombëtare dhe evropiane, duke përfshirë shqyrtimin e etapave të nevojshme për ta bërë vlerësimin:

Faza A: Përcaktimi i kontekstit dhe objektivave, caktimi i standardit bazë dhe e fushëveprimit të raportit

Përkufizimi i kontekstit dhe objektivave të vlerësimit kërkon profil strategjik me vëmendje të posaçme në dimensionin, përparësitë dhe objektivat strategjike të tij. Shqyrtimi i faktorëve kritik për të strukturuar vlerësimin strategjik ishte rezultat i kontekstit dhe shkallës në të cilën është realizuar VSM, përkthimi me integrimin e elementeve të mëposhtme (standardi bazë dhe fushëveprimi):

1. objektivat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në shkallë ndërkombëtare, të Bashkimit Evropian ose nivel shteti, të cilat lidhen me planin dhe mënyrën në të cilën këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së tij;
2. aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimi i mundshëm i tij pa zbatimin e planit ose programit dhe karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm;
3. problemet ekzistuese mjedisore që lidhen me planin ose programin, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si për shembull zonat e projektuara sipas Direktivave 79/409/EEC dhe 92/43/EEC.

Shqyrtimi i direktivave shtetërore dhe ndërkombëtare që lidhen me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm është marrë parasysh në lidhje me propozimet strategjike të PZHK të Hanit të Elezit. Ky studim i tërthortë ka mundësuar përzgjedhjen e një grumbulli të temave mjedisore dhe të qëndrueshmërisë. Këto tema janë analizuar më tej, ashtu që të caktohen kriteret, qëndrueshmëria dhe indikatorët për VSM. Prandaj, hapi i parë i procesit të vlerësimit të qëndrueshmërisë është që të shikohen planet, politikat dhe programet tjera përkatëse, të mblidhen të dhënat bazë dhe të identifikohen çështjet e qëndrueshmërisë në kuadër të Hanit të Elezit. Pastaj, këto informata duhet të shfrytëzohen për t'i zhvilluar objektivat e qëndrueshmërisë dhe një kornizë në bazë të së cilës bëhet vlerësimi i planit.

Faza B: Zhvillimi dhe përsosja e alternativave dhe vlerësimi i efekteve

Pas paraqitjes së të dhënave të para bazë në dispozicion dhe vendimit për fushëveprimin e raportit (nivele e hollësive dhe faktorëve të pritur që do të vlerësohen), janë analizuar objektivat dhe veprimet e programuara të PZHK-së. Në këtë fazë, PZHK është testuar për t'i identifikuar sinergjitë potenciale ose mospërputhjet ndërmjet objektivave të tij dhe objektivave të VSM-së. PZHK-ja është analizuar ashtu që të përsoset veprimet strategjike dhe të parashihen efektet e mundshme të planit dhe efektet mjedisore të rëndësishme. Kjo është një fazë e rëndësishme ku bëhet shqyrtimi i opsioneve të zbutjes. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor e ofron një listë të kriterëve relevante për përcaktimin e peshës së efekteve të mundshme të planifikimit në mjedis (në Shtojcën I të tij).

Krahas me zyrarët e UN-Habitatit dhe pas shqyrtimit të raportit të parë shkoqitës është vendosur që PZHK duhet t'i nënshtrohet një procesi të thjeshtë të vlerësimit, pa e shqyrtuar opsionin "Nuk ka plan", por përkundrazi duke u fokusuar në opsionet ekzistuese të planit dhe në efektet e mundshme të këtyre opsioneve (p.sh. më shumë zhvillime në një zonë të caktuar), duke i shqyrtuar nivelet e ndryshme të realizimit (pjesërisht ose tërësisht). Kjo ka për qëllim që ta ndihmojë procesin e vendim-marrjes në vlerësimin e pasojave të mundshme të realizimit ose vetëm realizimit të pjesshëm të planit, si dhe të jep opsione për ndikimet e mundshme negative të realizimit.

Është me rëndësi të thuhet se tre skenarët e propozuar në Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit kanë qenë të vlerësuara nga ekipi i PZHK-së bashkë me aktorët përkatës dhe me popullatën në seminare dhe takime të përbashkëta. Prandaj, ne mund të vlerësojmë vetëm ndikimet e mundshme të veprimeve të propozuara në çështjet kritike mjedisore. Kjo mund të ndihmojë për të vlerësuar efektet e parashikuara të planit dhe veprimeve të programuara të tij, si dhe të ndihmojë në përsosjen e planit duke i futur alternativat potenciale të realizimit dhe duke i shqyrtuar masat e zbutjes për cilindo ndikim negativ të identifikuar. Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë fazë është që të jepen hollësisht mjetet me anë të së cilave mund të vlerësohet performanca mjedisore e planit, duke propozuar një sistem monitorimi për realizimin e planit.

Procedurat e vlerësimit burojnë nga praktika e ndërtuar, duke e vënë theksin në masat për zbutje dhe përmirësim. Po ashtu, Ligji i Kosovës për VSM parasheh që të analizohen efektet ku përfshihen “efektet afat- shkurta, mesme dhe gjata, të përhershme dhe të përkohshme”. Efektet mund të ndryshojnë në shkallë të ndryshme kohore, dhe, megjithëse shkaktojnë ndikim në afat të shkurtë, mund të kontribuojnë në afat të gjatë, për shembull, në zvogëlimin e ndotjes së ajrit ose gazrave të serës. Për qëllimet e këtij raporti, VSM i ka shqyrtuar tri shkallë kohore: a) efektet afatshkurta (1-5 vite); efektet afatmesme (5-10 vite) dhe efektet afatgjata (10 e më shumë vitet e ardhshme). Këto janë zgjedhur për t’u përshtatur me afatet kohore për veprimet e propozuara në Plan (2010-2025, me rishikimet e pritura çdo 5 vite).

Faza C: Përgatitja e Raportit mjedisor

Në hapin në vazhdim paraqiten efektet e parashikuara mjedisore të planit ose programit në formë të një raporti, i cili i përfshin alternativat dhe është i përshtatshëm për konsultime publike dhe për shfrytëzim nga vendim-marrësit.

Faza D: Konsultimi dhe vendim-marrja

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor përcakton që informatat në Raportin Mjedisor dhe përgjigjet ndaj konsultimeve të merren parasysh gjatë përgatitjes së planit ose programit dhe përpara se të merret vendimi përfundimtar për miratimin e tij (Neni 14). Autoritetet përgjegjëse duhet ta hartojnë një përmbledhje për mënyrën se si i kanë marrë ato parasysh këto konkluzione, dhe se si janë integruar shqyrtimet mjedisore në atë plan ose program me informata të mjaftueshme për t’i bërë të qarta ndryshimet e bëra apo alternativat e refuzuara.

Ligji përcakton:

“Neni 14

Miratimi i planit apo programit

Autoriteti përgjegjës, merr parasysh raportin e VSM, rezultatet e konsultimeve përfshirë edhe konsultimet ndërshtetërore, gjatë përgatitjes së planit apo programit dhe para aprovimit.

Neni 15

Informacion për vendimin

1. Pas miratimit të një plani ose programi, për të cilin është kryer një vlerësim strategjik mjedisor, autoriteti përgjegjës do të informojë trupat konsultativ, publikun, personat të cilët kanë qenë të konsultuar, nga neni 9 nën-paragrafi 2.2. dhe Ministrin që plani ose programi është miratuar, datën e miratimit të tij, adresën, e cila mund të përfshijë një ueb faqe se ku mund të shihet ose sigurohet kopja e tij dhe e raportit të VSM.

2. Ministri do të informojë shtetin me të cilin janë zhvilluar konsultimet lidhur me planin ose programit për çështjet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Detajet e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni janë:

3.1. si janë integruar çështjet mjedisore në plan ose në program;

3.2. si është marrë parasysh raporti i VSM-së;

3.3. si janë marrë parasysh mendimet nga autoritetet konsultuese dhe publikut, përfshirë edhe konsultimet e publikut dhe ndonjë pikëpamje si rezultat i konsultimeve ndër shtetërore

3.4. arsyet për zgjedhjen e planit apo programit të miratuara nga shqyrtimi i alternativave të tjera të arsyeshme; dhe

3.5. masat që do të merren për monitorimin e efekteve të dukshme mjedisore nga implementimi i planit ose programit.

5. Përmbajtja dhe objektivat kryesore të PZHK të Hanit të Elezit

Propozimi për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit është në fazën përmbyllëse të tij. Propozimi i PZHK-së i është prezantuar publikut më 17 dhjetor 2010. Plani do të jepet në diskutim publik dhe agjencive

tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim për një periudhë prej së paku 60 ditësh, në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës.

VSM kishte filluar përpara prezantimit publik të PZHK-së së Hanit të Elezit në një fazë kur është e mundur të përfitohet nga vendimet strategjike të përbashkëta. Prandaj, korniza metodologjike është fokusuar në konceptin, strategjinë e përgjithshme, duke vepruar në proces dhe e integruar në përgatitjen e PZHK-së.

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit është duke u kryer nga Komuna e Hanit të Elezit në bashkëpunim me “Programin për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal” të UN-Habitatit në Kosovë (MuSPP). MuSPP ka filluar në vitin 2005 me përkrahjen financiare të Qeverisë Suedeze. Në përputhje me Nenin 13 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, secila komunë ka përgjegjësi për përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal duke e mbuluar tërë territorin e saj. Ky plan është një plan shumë sektorësh, i përcakton qëllimet e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor dhe është i hartuar për një periudhë së paku pesë vjeçare. Në rastin e Hanit të Elezit, plani synon në ndërtimin e zhvillimit për 2010-2025.

PZHK është i integruar në Planin Hapësinor të përgjithshëm të Kosovës (projekt, 2010). Objektivat parësore të PZHK-së së paraqitur këtu janë bazuar në PZHK-në (projekt, 2010). Deklarata e vizionit për Hanin e Elezit është: “komunë portë, urë ndërmjet shtetit të Kosovës me Maqedoninë që lidhen me dy kufij Bllace-Glloboqice me shërbime administrative të zhvilluara; zhvillim të shtuar nga prosperiteti industrial, tregtia, transporti, bujqësia, turizmi industrial, kulturor dhe transit, zhvillim të ekuilibruar me një vëmendje më të madhe ndaj mbrojtjes së mjedisit; me infrastrukturë teknike dhe shoqërore të zhvilluar dhe me jetë të shëndoshë për të gjithë”.




Fig 2: Propozim PZHk-ja e Hanit të Elezit, Harta e shfrytëzimit të tokës komunale, 2010

Modeli urban i përkufizuar synon promovim e zhvillimit të ekuilibruar të qëndrueshëm në të gjithë sektorët e komunës duke i vënë theksin synimeve të mëposhtme:

- Promovimi i zhvillimit kompakt, me dendësi më të madhe në tokën ndërtimore dhe përmirësimin e shërbimeve shoqërore në zonat kryesore urbane;
- Përcaktimi i lokacioneve edhe burimeve potenciale për zhvillimin komunal;
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Identifikimi i projekteve potenciale për bashkëpunimin ndërkufitar.

Qëllimet konkrete:

- Përkrahja e zhvillimit ekonomik, duke përfshirë veprimtaritë industriale, zhvillimin rural dhe promovimin e turizmit rural;
- Krijimi i një strukture urbane që mundëson një menaxhim të integruar dhe më të qëndrueshëm të infrastrukturës fizike, lëvizshmërisë dhe sistemeve të transportit;
- Përmirësimi i shërbimeve sociale me qasje për të gjithë qytetarët, promovimi i kohezionit social dhe strukturimi i zonave ekzistuese kryesore urbane;
- Mbrojtja mjedisore dhe zvogëlimi dhe zbutja e katastrofave, promovimi i rigjallërimit urban, ripyllëzimit, biodiversitetet dhe përkufizimit të rrjeteve ekologjike;
- Përmirësimi i banimit dhe kushteve të jetës për të gjithë qytetarët, duke siguruar banim për grupet e rrezikuara nëpërmjet ndihmës sociale, promovimi i dendësisit kompakt të zonave urbane, shfrytëzimi racional i hapësirave publike dhe shmangia e ndikimeve negative në zonat natyrore;
- Rritja e potencialeve ndërmjet komunave dhe atyre ndërkufitare.

Këto objektiva kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit janë konkretizuar me shumë në propozim PZHK-në, kreu 2.

6. Përkufizimi i faktorëve kryesor për procesin e vendim-marrjes

6.1. Tabela referuese strategjike

Siç u tha më herët, shqyrtimi i faktorëve kryesor për strukturimin e vlerësimit strategjik do ta përcaktojë nivelin bazë dhe vendos për fushëveprimin e VSM-së. Tabela referuese strategjike (TRS) në VSM i identifikon makro-orientimet e politikave shtetërore, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe objektivat afatgjata të përcaktuara përkitazi me mjedisin dhe qëndrueshmërinë.

PZHK/PZHU janë instrumentet themelore të planifikimit për realizimin e strategjive të përkufizuara në nivelet rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare, prandaj duhet të artikulohen me planet nga sektorët e ndryshëm (Tabela 4). Tani do të paraqesim objektivat kryesore të planeve dhe programeve të përmendura më sipër. Nga këto objektiva ne mund ta kuptojmë zhvillimin, të cilin po e promovojmë në një shkallë më të gjerë.

Tabela 4: Planet dhe programet zhvillimore kryesore

PLANET, PROGRAMET, POLITIKAT	
AGJENDA 21	Parimet për zhvillimin e qëndrueshëm
EU EBS	Strategjia evropiane e biodiversitetit
EU ESDP	Perspektiva evropiane e planifikimit hapësinor
LIGJI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR	Ligji i Kosovës nr. 2003/14 dhe Ligji për ndryshimin e tij nr. 03/L-106 i datës 2008
LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	Ligji i Kosovës nr. 03/L-025 i datës 2009
LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES	Ligji i Kosovës nr. 03/L-043 i datës 2009
PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS	Projekt versioni i datës 2010

Tabela 5 e dokumenton lidhjen e krijuar ndërmjet PZHK-së dhe planeve, programeve dhe objektivave tjera përkatëse për mbrojtjen mjedisore. Në tabelë shihet koherenca ndërmjet planeve dhe programeve nga shkallët ndërkombëtare në ato vendase dhe ndërmjet sektorëve të ndryshëm me çka vërtetohen tematikat e vazhdueshme.

Tabela 5: Tabela referuese

PLANET, PROGRAMET, POLITIKAT	OBJEKTIVAT DHE QPLIMET KRYESORE të aplikueshme për zhvillimin komunal	QASJA E PZHK TË HANIT TË ELEZIT
AGJENDA 21	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet liberalizimit të tregtisë; - Përkrahja e ndërsjellë e tregtisë dhe mjedisit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i transparencës në administratë dhe vendim-marrje; - Ofrimi i mundësive për ndërmarrjet e vogla, bujqësore ose jobujqësore dhe për popullatën vendase dhe komunitetet lokale: kreditë për mbështetjen e prodhimit (agrobizneset) dhe bizneset e industrisë së lehtë; ndarja e tokës me çmime konkurrense dhe lehtë e punëshme dhe zhvilluar për qëllime industriale, përfshirë mundësitë për ri-zhvillimin e djerrinave industriale; përkrahjes për krijimin e fermave të reja; krijimin e një brendi të prodhimeve lokale. - Inkurajimi i sektorit privat dhe përkrahja e ndërmarrësish duke përmirësuar mbështetjen institucionale për krijimin e ndërmarrjeve dhe futjen në treg, në veçanti zhvillimin komercial.
EU EBS	<ul style="list-style-type: none"> - Konservimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i diversitetit biologjik; - Ndarja e përfitimeve që dalin nga burimet gjenetike; - Hulumtimi, identifikimi, monitorimi dhe shkëmbimi i informatave; - Arsimimi, aftësimi dhe vetëdijësimi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe konservimi i biodiversitetit.

EU ESDP	<ul style="list-style-type: none"> - Kohezioni ekonomik dhe shoqëror; - Konservimi dhe menaxhimi i burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Shtimi i cilësisë në sektorët e arsimit, shoqëror, kulturor, kujdesit shëndetësor dhe aktiviteteve sportive; - Promovimi i mundësive për punësim lokal; - Rritja e mundësive për banim social dhe jo shumë të kushtueshëm; - Krijimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë, rrjetit të kanalizimit dhe sistemit të menaxhimit të mbeturinave; - Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit; - Dekontaminimi dhe ri-zhvillimi i zonave të kontaminuara; - Zvogëlimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis, përfshirë rryllëzimin e zonave me erozion të lartë; - Mbrojtja e trashëgimisë kulturore.
LIGJI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR	<ul style="list-style-type: none"> - Mbrojtja e burimeve natyrore dhe avokimi për zhvillim të qëndrueshëm; - Promovimi i një procesi përfshirës dhe pjesëmarrës për formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike, i cili i përfshin aktorët dhe komunitetet pa diskriminim, si meshkujt ashtu edhe femrat; - Promovimi i transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe të vendim-marrjes; - Promovimi i mundësive të barabarta ekonomike dhe shoqërore; - Promovimi i përmirësimit të kushteve të jetës dhe modelit të ekuilibruar mirë të vendbanimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe konservimi i biodiversitetit; - Promovimi i transparencës në administratë dhe vendim-marrje; - Përmirësimi i shërbimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor për të gjithë banorët; - Rritja e mundësive për banim social dhe jo shumë të kushtueshëm; - Krijimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë, rrjetit të kanalizimit dhe sistemit të menaxhimit të mbeturinave.
LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i shfrytëzimit racional të burimeve natyrore dhe kufizimit të ndotjes së mjedisit, parandalimi i dëmtimit, rehabilitimi dhe përmirësimi i mjedisit të dëmtuar; - Promovimi i përmirësimit të kushteve mjedisore në korrelacion me kushtet për jetë dhe me mbrojtjen e shëndetit njerëzor; - Ruajtja dhe mirëmbajtja e burimeve natyrore, qofshin apo jo të ripërtërishme, si dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tyre; - Stimulimi dhe pjesëmarrja publike në aktivitetet përkitazi me mbrojtjen mjedisore; - Të sigurojë që zhvillimi në Kosovë të jetë i qëndrueshëm në mënyrë që të mbrohet dhe ruhet toka, ajri, uji, burimet e gjalla në Kosovë për të mirën e gjeneratave që do të vijnë; 	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi dhe përmirësimi i furnizimit me ujë, rrjetit të kanalizimit dhe sistemit të menaxhimit të mbeturinave; - Mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit; - Dekontaminimi dhe ri-zhvillimi i zonave të kontaminuara; - Zvogëlimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis, përfshirë rryllëzimin e zonave me erozion të lartë; - Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe konservimi i biodiversitetit; - Rritja e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe atij ndërkuftar lidhur me urbanizimin, mjedisin dhe menaxhimin e pyjeve.

	- Promovimi i masave rajonale dhe ndërkombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë mjedisore.	
LIGJI PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES	Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes që del nga veprimtaritë industriale, në veçanti duke parandaluar ose zvogëluar mbeturinat dhe emisionet në ajër, ujë dhe tokë.	- Zvogëlimi i ndikimit negativ të industrisë duke siguruar që ndotësit ta respektojnë ligjin; - Krijimi i një rripi të gjelbër përgjatë fabrikës së çimentos.
PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS	- Zhvillimi i një rrjeti atraktiv të qyteteve të planifikuara, me qeverisje të shërbimeve publike në favor të qytetarit, me rritje të cilësisë së jetës për qytetarët, punësimi dhe barazia shoqërore; - Përkrahja e ZHEK LED – shfrytëzimi i prioritetëve konkurruese; - Zhvillimi i lidhjeve efikase ndër-urbane me zonat tjera, dhe më gjerë në zonat e rajonit, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, ICT). - Zhvillimi i shërbimeve komerciale, , agro-industriale, turizmit, intensifikimi i politikave për mbrojtjen dhe ringjalljen e mjedisit.	- Funkzioni kryesor i qendrës kryesore dhe nën-qendrës është përplotësues për vendbanimet tjera; - Përmirësimi i shërbimeve shoqërore me qasje për të gjithë banorët; - Përmirësimi i kushteve për jetë dhe banimit për të gjithë banorët; - Rritja e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe atij ndërkufitar; - Rritja e kapaciteteve industriale, zhvillimi i bujqësisë, promovimi i turizmit rural; - Konservimi dhe mbrojtja dhe restaurimi i mjedisit natyror dhe biodiversitetit.

6.2. Çështjet mjedisore

Shqyrtimi i planeve dhe programeve që e prekin komunën dhe strukturimi i të dhënave bazike mjedisore, kanë shërbyer si informata për identifikimin e një vargu të çështjeve mjedisore që janë të rëndësishme për PZHK-në. Këto janë ilustruar në Tabela 6. Këto çështje, probleme dhe mundësi janë konfirmuar nëpërmjet:

- Diskutimeve me zyrtarët e UN-Habitatit;
- Shqyrtimit të dhënave bazike dhe
- Tensioneve me planet, programet dhe objektivat tjera të qëndrueshmërisë.

Tabela 6: Çështjet dhe mundësitë në Hanin e Elezit.

FAKTORËT	ÇËSHTJET	SI JANË ADRESUAR ÇËSHTJET NË PROPOZIM PZHK-në
Cilësia e ajrit	- Fabrika ekzistuese e çimentos nuk i përmbahet rekomandimeve mjedisore; - Zhvillimi industrial i mëtejshëm mund të sjellë më shumë ndotje; - Më shumë zhvillim në Gorancë mund të sjell më shumë komunikacion dhe të përkeqësohet ndotja e ajrit; - Transporti publik është i dobët.	- Krijimi i sistemit për monitorimin e ajrit; - Të sigurojë që ndotësit do ta respektojnë ligjin; - Ripyllëzimi; - Krijimi i rripit të gjelbër rreth fabrikës së çimentos; - Ofrimi i më shumë mënyrave të udhëtimit të qëndrueshëm; - Përmirësimi i hapësirave për çiklistë dhe këmbësorë; - Synon të plotësojë më shumë nevojat në nivel lokal ashtu që të zvogëlohet nevoja për të udhëtuar. Mundësitë për t'i shqyrtuar: - Zhvillimi i partneriteteve me ndërmarrjet industriale ekzistuese dhe atyre të interesuara, si dhe me institucionet kërkimore/akademike për të hartuar

		<p>strategjitë dhe aktivitetet në fushën e mjedisit/teknologjisë.</p> <p>- Promovimi i automjeteve me emision të ulët (p.sh. hibride, LPG, CNG).</p>
Biodiversiteti	<p>- Shpyllëzimi ilegal;</p> <p>- Shtimi i aktiviteteve minerare, industriale dhe zhvillimi urban mund ta rrezikojnë më tej mjedisin natyror.</p>	<p>- Ripyllëzimi.</p> <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <p>- Zhvillimi i partneriteteve me ndërmarrjet industriale ekzistuese dhe atyre të interesuara, si dhe me institucionet kërkimore/akademike për të hartuar strategjitë dhe aktivitetet në fushën e mjedisit/teknologjisë;</p> <p>- Krijimi i një Qendre për interpretim mjedisor për identifikimin e lokacioneve të biodiversitetit, krijimi i një sistemi të monitorimit për faunën dhe florën dhe zhvillimi i veprimtarive edukative mjedisore.</p>
Faktorët klimatik	<p>- Adaptimi i strategjive ka gjasë të jetë i nevojshëm;</p> <p>- Niveli i lartë i GS;</p> <p>- Blegtoaria prodhon nivel të lartë të GS.</p>	<p>- Ripyllëzimi;</p> <p>- Zvogëlimi i nevojës për të udhëtuar nëpërmjet planifikimit të shfrytëzimit të integruar të tokës (kompaktësia urbane, bashkërendimi i planifikimit dhe ndërtimit të objekteve të komunikacionit, në veçanti autostrada dhe përmirësimi i objekteve lokale/rajonale të komunikacionit);</p> <p>- Krijimi i strukturave për çiklistë dhe këmbësorë.</p> <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <p>- Promovimi i shfrytëzimit dhe prodhimit të energjisë së ripërtërishme (p.sh. për zhvillimet e reja);</p> <p>- Promovimi i efikasitetit më të madh energjetik.</p>
Trashëgimia	<p>- Trashëgimia vendore e lënë pas dore në rrezik;</p> <p>- Shqetësimi se zhvillimi i ri dhe përmirësimi i banimit mund ta rrezikojnë më tej trashëgiminë ekzistuese;</p>	<p>- Mbështetja e turizmit kulturor dhe rural;</p> <p>- Identifikimi dhe regjistrimi i arkitekturës vendore;</p> <p>- Projekt plani i konservimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe industriale;</p> <p>- Përkrahja e konservimit të shtëpive tradicionale në zonat rurale;</p> <p>- Promovimi i publikimeve lidhur me trashëgiminë lokale.</p> <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <p>- Integrimi i "shtigjeve" ekzistuese kulturore dhe krijimi i partneriteteve ndërkufitare për t'i promovuar itinerarët kulturorë/turistikë;</p> <p>- Krijimi i partneriteteve me institucionet shkencore/akademike në fushën e konservimit të trashëgimisë (p.sh ICOMOS, shoqatat e arkitektëve ose arkeologëve).</p>
Menaxhimi i mbeturinave	<p>- Komuna nuk është e mbuluar tërësisht nga mbledhja e mbeturinave publike;</p> <p>- Mbeturinat industriale të lëngshme aktualisht janë duke u derdhur në lum;</p> <p>- Deponitë ilegale të mbeturinave;</p>	<p>- Krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave;</p> <p>- Krijimi i një kompanie publike për fushatat e menaxhimit të mbeturinave;</p> <p>- Promovimi i programeve për zvogëlimin e mbeturinave përmes riciklimit;</p> <p>- Përkrahja e OJQ-ve për organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijesimit për riciklimin;</p> <p>- Sjellja e kontejnerëve të mbeturinave në të gjitha vendbanimet dhe lagjet;</p> <p>- Përcaktimi i lokacioneve për mbeturinat industriale dhe</p>

		<p>ndërtimore.</p> <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i përzjerjes së mbeturinave; - Zhvillimi i mëtejshëm i aktiviteteve të kompanive publike për të përfshirë krijimin e veprimtarive ekonomike që lidhen me ri-shfrytëzimin dhe riciklimin.
Toka	<ul style="list-style-type: none"> - Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave të ngurta; - Ekzistimi i mbetjeve helmuese kancerogjene të nga industria e azbestit dhe çimentos; - Kultivimi i blegtorisë është burim i madh i degradimit të tokës dhe ujit; - Nuk ka të dhëna specifike për tokën. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i zonave që konsiderohen të kontaminuara; - Dekontaminimi i zonave të identifikuara (azbesti); - Dekontaminimi i zonave të degraduara përgjatë brigjeve të lumit. <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një projekti për rigjallërimin e brigjeve të lumit, duke kombinuar dekontaminimin, zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet, krijimin e shtegut për çiklistë, këmbësorë, aktivitetet e lira dhe për edukimin mjedisor.
Uji	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesë e furnizimit me ujë të pijes; - Ndotja e ujit; - Zhvillimi i programuar urban, bujqësor dhe industrial do ta rrisë kërkesën për ujë; - Nuk ka të dhëna specifike për ujin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i ujit të pijes për të gjitha vendbanimet (ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit). <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i sistemit të monitorimit për vlerësimin e cilësisë kimike dhe biologjike të ujit; - PZHK përmend nevojën për vlerësimin e mëtejshëm të burimeve të ujit megjithëse nuk është treguar asnjë masë konkrete për zbatim.
Faktorët shoqëror dhe ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> - Nevoja për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike, kryesisht e objekteve sportive-rekreative, arsimore dhe shëndetësore; - Shkallë e lartë e papunësisë; - Nevoja për të përmirësuar cilësinë e banimit; - Nevoja për të krijuar banimin social - Shtimi i propozuar i banimit në Gorancë kërkon investime në transport dhe të tjera; - Rreziku e shpopullimit; - Autostrada e re do ta shtojë ndotjen me zhurmë - Nuk ka të dhëna për çështjet e shëndetit (kryesisht shëndeti i lehonave dhe vdekshmëria e foshnjave). 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i shërbimeve publike; - Rritja e zhvillimit të kapaciteteve profesionale për personelin shëndetësor dhe arsimor; - Ofrimi i shërbimeve teknike të nevojshme për përmirësimin e kushteve të jetës; - Zhvillimi rural si një mundësi për krijimin e vendeve të punës; - Aftësimi i të rinjve për tregjet e reja të punës. <p>Mundësitë për t'i shqyrtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i banimit me dendësi më të madhe pa e dëmtuar mënyrën apo kushtet e jetës (kryesisht nëpërmjet plotësimit të brendshëm); - Shqyrtimi i miratimit të bio-bujqësisë; - Shqyrtimi i miratimit të teknologjive ndërtimore të gjelbra, kryesisht arkitektura tradicionale dhe miratimi i dizajnit të mirë për të promovuar mjedisin me cilësi ndërtimi; - Vlerësimi dhe monitorimi i çështjeve shëndetësore; - Zhvillimi i programeve student/mësimdhënës (profesionale, ndihmë për studentët, etj.); - Formimi i një grupi punues me shërbime ministrale për vlerësimin e ndikimit të autostradës në zhvillimin e qytetit dhe për analizimin e kostos dhe përfitimeve duke e shqyrtuar opsionin e përmirësimit të rrugës dhe hekurudhës ekzistuese.

Pjesa II – VLERËSIMI MJEDISOR

7. Gjendja e mjedisit

7.1. Cilësia e ajrit

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Direktiva 1996/62/EC e BE-së për Cilësinë e ajrit në ambient e përcakton kornizën për ta trajtuar ndotjen lokale të ajrit duke krijuar standarde të reja të cilësisë së ajrit për ndotësit që nuk kanë qenë të rregulluar më parë. Në Direktivën 2008/50/EC, Komisioni Evropian i ka caktuar kufijtë për PM10 në ajër (Shiko Tabela 7). Përveç kësaj, në nivelin shtetëror, Ligji i Kosovës nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes i përkufizon një numër të objektivave të cilësisë së ajri për disa nga ndotësit.

	Vlera kufitare e PM10
Mesatarja vjetore	40 µg/m³
Mesatarja ditore (24-orë)	50 µg/m³
Numri i lejuar i tejkalimeve gjatë vitit	35

Tabela 7: Vlerat kufitare për grimcat e imëta (PM10)

Informatat bazë

Monitorimi i cilësisë së ajrit është i rëndësishëm për të siguruar që nivelet e ndotësve të identifikuar të mbeten nën standardet dhe synimet shtetërore për t'i mbrojtur shëndetin njerëzor dhe ekosistemet. Ligji i Kosovës e përkufizon listën e substancave kryesore ndotëse, të cilat duhet të merren parasysh për rregullimin e vlerave të kufirit të emetimit:

- Oksidet e azotit (NOX);
- Dyoksidi i azotit (NO2);
- Dyoksidi i squfurit (SO2);
- Bashkë dyzimet organike të avullueshme;
- Metalet dhe bashkë dyzimet e tyre;
- Pluhuri;
- Azbesti (hollësitat e larguara, fibrat);
- Klori dhe bashkë dyzimet e tij;
- Fluori dhe bashkë dyzimet e tij;
- Arseni dhe bashkë dyzimet e tij;
- Cianidet;
- Substancat dhe përbërjet tjera të cilat janë dëshmuar si posedues të elementeve kancerogjene, mutagjene ose elemente të cilat mund të ndikojnë në riprodhim përmes ajrit;
- Dibenzodioksinet poliklorinike dhe dibenzofuranet poliklorinike.

Tabela 8: Nivelet e ndotësve të ajrit (burimi: propozim PZHK-ja e Hanit të Elezit, 2010)

NDOTËSIT	NJËSIA	2003	2004	2005	2006	2007	2008	VLERAT E LEJUARA
Pluhuri	MG/Nm3	250	108	120	100	60	78	50
NOx	MG/Nm3	470	420	350	350	182	235	800
SO2	MG/Nm3	820	548	590	580	564	608	400

Të dhënat e mbledhura në PZHK (2003-2007) janë paraqitur në Tabela 8 por janë të pakompletuara dhe nevojitet monitorim i mëtejshëm. Po ashtu, nuk ka parashikim të dhënave në dispozicion. Këto informata janë duke u mbledhur aktualisht me anë të një detyre konsulente. Të dhënat tregojnë ngritje të niveleve të gjithë ndotësve prej 2007 deri 2008, ku pluhuri dhe dyoksidi i squfurit janë përmbi vlerat kufitare të lejuara me standardet kosovare. Monitorimi i mëtejshëm do t'i vlerësojë substancat tjera ndotëse, siç është paraparë nga Ligji i Kosovës për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

7.2. Biodiversiteti

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Ekzistojnë disa marrëveshje ndërkombëtare që merren me çështjet e rëndësishme të biodiversitetit. Konventat e Ramsarit, Bonit dhe Bernit synojnë mbrojtjen e tokave moçalike, specieve migruese, kafshëve të egra dhe habitateve natyrore, kurse Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Konventa më e re për Diversitetin Biologjik dhe Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit e theksojnë rëndësinë e gjithëmbarshme të biodiversitetit dhe konservimit të tij.




Fig 3: Zonat natyrore (burimi: propozim PZHK-ja e Hanit të Elezit, 2010)





Fig 4: Zonat natyrore dhe monumentet e mbrojtura në Kosovë (burimi: Plani Hapësinor i Kosovës, projekt 2010)

Në nivelin evropian, Direktiva për Zogjtë dhe Habitatet dhe Strategjia e BE-së për Biodiversitetin japin dispozita më konkrete të cilat duhet të modifikohen më tej në legjislacionin shtetëror. Ligji i Kosovës për mbrojtjen e mjedisit thekson se “Vlerat e mbrojtura të natyrës përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e natyrës” dhe se “Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojlojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës”. Ai e thekson përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit për të siguruar që monitorimi i mjedisit të kryhet nëpërmjet matjeve, hetimeve dhe vlerësimeve sistematike, të treguesve të gjendjes, dhe matjeve të Ndotjes së Mjedisit, ku përfshihet matja e faktorëve natyror, respektivisht ndryshimet në gjendjen dhe karakteristikat e mjedisit, duke përfshirë këtu monitorimin ndërkufitar si; ajri, uji, toka, pyjet, biodiversiteti, flora dhe fauna, elementet klimatike, shtresa e ozonit, rrezatimi jonizues dhe jo-jonizues, zhurma, mbeturinat, paralajmërimi i hershëm i aksidenteve dhe vlerësimi i shkallës së Ndotjes së Mjedisit, si dhe obligimin dhe përgjegjësitë, të cilat janë marrë nga marrëveshjet ndërkombëtare. Parku Nacional “Bjeshkët e Sharrit” nuk i përfshin zonat natyrore të mbrojtura në kuadër të komunës së Hanit të Elezit (shih Fig 4). Plani Hapësinor i Kosovës parasheh që komunat në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor (MMPH), duhet ta hartojnë planin rregullues për zona të caktuara në mënyrë që të mbrohen lerrat e peizazhit natyror.

Informatat bazë

Komuna e Hanit të Elezit është e pasur me burime natyrore dhe i integron zonat peizazhore të cilat aktualisht nuk janë të mbrojtura, d.m.th Malet e Sharrit dhe Karadakut, Lugina e Lepencit dhe zonat rurale



(shih

Fig 3). Zonat natyrore janë zona bio-gjeografike që e pasqyrojnë bazën gjeologjike, sistemin hidrologjik, kafshët e egra, sistemet dhe proceset natyrore në atë zonë. Zonat natyrore e ofrojnë kontekstin në të cilin PZHK-ja mund të mundohet që ta sigurojë, përforcojë dhe avancojë biodiversitetin dhe tiparet natyrore që e karakterizojnë Hanin e Elezit. Profili i PZHK-së e ka identifikuar rrezikun e shpyllëzimit. Harta e propozuar për shfrytëzimin e tokës komunale, i përkufizon këto zona në mënyrë që t'i mbrojë dhe integrojë rrjetet ekologjike në tërë peizazhet komunale dhe ato përreth. Por, lokacionet me biodiversitet nuk janë identifikuar (lokacione që mund të caktohen si të tilla për shkak të vlerës së biodiversitetit të tyre). PZHK-ja

raporton për një numër të specieve që ka mundësi potenciale të përdoren për monitorim: lepujt e egër, urithët, pëllumbat e egër dhe zogjtë e malit, insektet dhe zvarranikët si hardhucat, gjarpërinjtë, picërrakët, breshkat, bretkosat, etj. Nuk ekziston asnjë studim apo monitorim i këtyre specieve. Vetë komuna e Hanit të Elezit ka një zonë pyjore prej 3878 ha që mbulon 47% të territorit të përgjithshëm të komunës. Kjo e tejkalon përfshirjen e zonave pyjore në Evropën kontinentale prej 30%.

7.3. Faktorët klimatik

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Konventa Kornizë e OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe Protokoli i Kjotos i ofrojnë orientimet ndërkombëtare për ballafaqimin me ndryshimet klimatike. Po ashtu, Deklarata e Mijëvjeçarit dhe Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit të OKB-së dhe Programi i Gjashtë i BE-së për Veprim Mjedisor e theksojnë rëndësinë e saj, ndërsa Direktiva e BE-së për Bio Karburante dhe Direktiva e BE-së për promovimin e Rrymës elektrike nga Energjia e Ripërtërishme i përcaktojnë masat specifike për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Çështja e ndryshimeve klimatike ka nevojë për masa që duhen ndërmarrë në të gjitha nivelet e administratës, duke i përcaktuar propozimet e masave për zvogëlimin e emisioneve të karbonit.

Informatat bazë

Ndryshimet klimatike janë çështja kryesore e thelbit të debatit mjedisor dhe të qëndrueshmërisë. Ndryshimet klimatike shkaktohen pjesërisht nga gazrat e efektit serë, të cilat e ngrohin Tokën dhe shkaktojnë rritjen e temperaturave. Djegia e karburanteve fosile është një nga kontribuuesit e mëdhenj të prodhimit të gazrave të serës. Ndryshimet klimatike kanë ndikim direkt në zonat urbane, me pasoja të mundshme në rrezikun e ngritjes së nivelit të deteve, rritjen e rrezikut nga përmbytjet, stuhitë, thatësitat, etj. PZHK i Hanit të Elezit i paraqet propozimet për promovimin e kompaktësisë urbane nëpërmjet rregulloreve për shfrytëzimin e tokës, si dhe i paraqet objektivat për inkurajimin e shfrytëzimit të formave jo-motorike të transportit, strukturave për ciklistë dhe këmbësorë, promovimin e alternativave kundruall automjeteve private, promovimi i bashkërendimit të planifikimit dhe ndërtimit të objekteve të transportit, në veçanti të autostradës dhe përmirësimi i objekteve rajonale të transportit. Nuk ka të dhëna për emetimet e karbonit nga shfrytëzimi komercial dhe familjar, transporti rrugor, ose ndryshimet në shfrytëzimin e tokës. Po ashtu, nuk ka të dhëna për shpenzimin e energjisë dhe nuk është e mundur të vlerësohet emetimi i karbonit për kokë banori për Hanin e Elezit.

7.4. Trashëgimia kulturore

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor synon një zhvillim të ardhshëm të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm dhe përfshin konservimin e trashëgimisë kulturore si një prej qëllimeve themelore. Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligji për Zonat e Posaçme Mbrojtëse në Kosovë nuk përfshijnë masa konkrete për t'u zbatuar nga komuna. Plani Hapësinor i Kosovës e pohon rrezikun e lartë të degradimit të vazhdueshëm të komplekseve urbane, arkitekturës, mjedisit dhe monumenteve të trashëgimisë së qyteteve dhe zonave të posaçme, si dhe mungesën e të dhënave lidhur me trashëgiminë kulturore, duke e vënë mbrojtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore si një prej objektivave kryesore të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, ai propozon krijimin e një Inventari (baze të dhënave) të objekteve dhe lokacioneve në tërë Kosovën. Po ashtu, ky Plan i përmend një numër të masave që duhen marrë në fushat e arsimit, informimit, bashkëpunimit ndër-institucional dhe nevojën për t'i hartuar planet rregulluese për zonat e trashëgimisë dhe planet për konservimin dhe menaxhimin e lokacioneve të trashëgimisë kulturore. Plani i Kosovës e përmend edhe turizmin kulturor si një faktor potencial për zhvillimin e vendit.

Informatat bazë

Trashëgimia kulturore e Hanit të Elezit është shumë e pasur për sa i përket arkitekturës vendore dhe vendbanimeve tradicionale, por shumë e rrezikuar për shkak të mosekzistimit të inventarit të trashëgimisë dhe masave mbrojtëse. PZHK-ja përfshin objektivin e mbrojtjes së vlerave kulturore të tij në qëllimin për zhvillimin rural, që e shoqëron promovimin e turizmit rural. Inventari i arkitekturës tradicionale dhe studimi Vlerësimi strategjik mjedisor për Propozim planin zhvillimor komunal të Hanit të Elezit |

i fshatrave tradicionale do të jetë pikënisja e zbatimit të kësaj mase. Por, aktualisht të dhënat nuk janë duke mbledhur dhe nuk është krijuar asnjë partneritet për të siguruar studimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. PZHK-ja e ka vlerësuar listën e vlerave kulturore që do të valorizohen dhe nevojën për ekspertë në terren që të angazhohen në mbledhjen e të dhënave. Bazat e të dhënave në dispozicion nga Qendra për Trashëgimi Kulturor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përkritazi me trashëgiminë vendore, trashëgiminë fetare, lokacionet arkeologjike dhe komplekset e objekteve (përfshirë arkeologjinë industriale) janë të pamjaftueshme.

7.5. Menaxhimi i mbeturinave

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Samiti Botëror në Johannesburg (2002) dhe Programi i BE-së për Veprim Mjedisor e kanë theksuar nevojën për efikasitet më të madh të resurseve, zvogëlimin e mbeturinave dhe promovimin e energjisë të ripërtërishme për ta realizuar zhvillimin e qëndrueshëm. Legjislacioni evropian është krijuar për t'u përballur me këto çështje; kryesisht nëpërmjet të Direktivës për Deponitë, që synon zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi dhe Direktiva Kornizë për Mbeturinën, e cila e thekson rëndësinë e hierarkisë së mbeturinave që e krijon kuadrin për licencimin kombëtar për menaxhimin e mbeturinave. Plani Hapësinor i Kosovës parasheh që mbeturinat duhet të mblidhen, grumbullohen dhe të ndahet ajo që mund të riciklohet, të transportohet në deponi dhe të ruhen aty; mbeturinat mund të ruhen vetëm në deponitë rajonale legale; komunat në bashkëpunim të ngushtë me MMPH-në duhet t'i eliminojnë deponitë ilegale; ndërsa komunat me kompanitë publike rajonale për menaxhimin e mbeturinave duhet ta organizojnë riciklimin.

Informatat bazë

Mbrojtja dhe avancimi i mjedisit duhet të jenë të integruara në masat për zvogëlimin e mbeturinave të hedhura dhe për strukturimin e sistemit jo-ekzistues për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Hanit të Elezit. PZHK-ja i përcakton objektivat për krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe promovimin e programeve për zvogëlimin e mbeturinave nëpërmjet riciklimit. Të dhënat në dispozicion për mbledhjen e mbeturinave komerciale dhe banesore të ngurta tregojnë se mesatarisht mblidhen 100 m³/muaj nga to dhe supozohet se aktualisht nuk mblidhen edhe rreth 70 m³/muaj. Hedhja e mbeturinave do të sjell deri te shkarkimi i ndotësve në tokë dhe ujërat nëntokësore (p.sh. nëpër deponi), lirim i CO₂, metanit dhe gazrave helmuese, si dhe do të sjell deri te emetimet e dyoksideve, acideve hidroklorike dhe të merkurit/zhivës (p.sh. gjatë djegies së mbeturinave). Sa i përket sasisë, burimet më të rëndësishme të mbeturinave kryesisht janë nga industria, minierat, bujqësia dhe ekonomitë familjare.

7.6. Toka

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Ndikimet zhvillimore në tokë janë integruar në çështjet tjera mjedisore, si ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit dhe braktisja/lënia shkret. Në nivelin evropian, Programi i BE-së për Veprim Mjedisor e thekson mbrojtjen e tokës si një nga prioritetet kryesore për të ardhmen. Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit synon të sigurojë që zhvillimi në Kosovë të jetë i qëndrueshëm në mënyrë që të mbrohet dhe ruhet toka, ajri, uji, burimet e jetës për të mirën e gjeneratave të ardhme. Po ashtu, ai parasheh që Plani për Veprim Mjedisor i Kosovës duhet të hartohet për (përveç qëllimeve tjera) mbrojtjen e tokës. Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për të siguruar që monitorimi i mjedisit të kryhet nëpërmjet matjeve, hetimeve dhe vlerësimeve sistematike të treguesve të gjendjes, dhe matjes së ndotjes së mjedisit, ku përfshihen të dhënat për tokën. Ligji i Kosovës për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes e përmend edhe mbrojtjen e tokës kur kërkohet leja për instalimin e veprimtarive siç janë industria apo menaxhimi i mbeturinave.

Informatat bazë

Tokat e Hanit të Elezi kryesisht janë të klasifikuara si toka të kafta të cekta mbi shist ose gurë gëlqeror dhe humusore mbi serpentinë (shih Foto 5). Po ashtu, PZHK-ja i identifikon rezervat natyrore kryesore. PZHK-ja i identifikon rreziqet më të rëndësishme të shkaktuara nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave të ngurta

dhe nga mbetjet helmuese kancerogjene nga prodhimi i azbestit dhe çimentos. Për këtë studim nuk kemi mundur të sigurojmë informatat lidhur me kontaminimin e tokës.




Foto 5: Klasifikimi i tokës (burimi: propozim PZHJ-ja e Hanit të Elezit, 2010)

Tabela 9: Rezervat natyrore (burimi: propozim PZHK-ja e Hanit të Elezit, 2010)

NR.	EMRI	LOKACIONI	REZERVAT (TON)	VËREJTJE
1	Merzele	Hani i Elezit	134,382.60	I verifikuar
2	Merzele	Paldenicë	259,850.30	I verifikuar
3	Argjila	Paldenicë	263,924.60	I verifikuar
4	Guri gëlqeror	Seçishtë		I paverifikuar
5	Guri gëlqeror	Rezhancë		I paverifikuar
6	Guri dekorativ	Dremjak		I paverifikuar
7	Mermeri dhe guri gëlqeror	Kashan		I paverifikuar
8	Kromi	Rezhancë, Gurane and Kryenik		I paverifikuar
9	Hekuri	Laç		I paverifikuar
10	Ujërat (gazërat) minerale	Hani i Elezit		I paverifikuar

7.7. Uji

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Në nivelin ndërkombëtar, PZHK e thekson nevojën për t'u ballafaquar me ndryshimet klimatike, konservimin e biodiversitetit dhe mbrojtjen e burimeve të ujërave. Në Evropë, Direktiva Kornizë për Ujin kërkon nga Shtetet Anëtare që të arrijnë një 'status ekologjik të mirë' të organeve të brendshme për ujin deri në vitin 2015, kurse Direktiva e BE-së për Nitratet e adreson ndotjen e përhapur nga bujqësia. Në Kosovë, Ligji për Parandalimin e Integruar Mjedisor dhe Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, përcaktojnë se si mund të ndihmojë sistemi i planifikimit në zvogëlimin e ndotjes së rrjedhave të ujërave dhe rreziqeve nga përmytjet, si dhe promovojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e përbërësve mjedisor, konkretisht ujit. Plani Hapësinor i Kosovës e promovon edhe zbatimin e masave për promovimin e mbrojtjes së ujërave nëntokësore dhe integrimin e sistemeve të ujërave të zeza dhe kanalizimit. Në Planin Hapësinor të Kosovës ndotja e lumit Lepenc është renditur në kategorinë "II-III" prej gjithsej "IV" kategorive.

Informatat bazë

Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat për cilësinë kimike dhe biologjike të lumenjve nuk kemi mund t'i gjejmë. Mirëpo, ekziston shqetësimi lidhur me nivelin e ndotjes së ujit (ujërave nëntokësore, ujërave sipërfaqësore, lumenjve) përmbi sasitë e substancave ndotëse që vijnë nga industria të cilat vazhdojnë ta rrezikojnë cilësinë e ujit. PZHK raporton për gjendjen e tanishme të ndotjes së ujit në lumin Lepenc dhe degëve të tij si pasojë e ujërave të patrajuara nga sistemi i kanalizimit e kombinuar me ndotjen kimike nga industria e rëndë. Në hartën e përmytjeve të Kosovës, Hani i Elezit nuk konsiderohet si zonë me përmytje. Në bazë të një analize në terren të kryer nga ekipi i MuSPP të UN-Habitatit, në vitin 1979 ka pasur përmytje në "Lagjen e Ranave". Po ashtu, PZHK e përmend edhe përmytjen vjetore në lagjen e re Seqishte, të shkaktuar nga shkrirja e borës dhe shirat e mëdha. Këto zona potenciale për përmytje janë përkufizuar në hartën Hidrologjike të PZHK-së.

7.8. Faktorët shoqëror dhe ekonomikë

7.8.1. Demografia dhe shëndeti njerëzor

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Shëndeti publik mund të ndikohet dhe përmirësohet në masë të madhe me anë të procesit të planifikimit. Planifikimi mund të krijojë masa për t'i përkrahur mënyrat e shëndetshme të jetës dhe zvogëluar kërkesat për shërbime dhe resurse, veçmas duke i siguruar sistemet për furnizimin me ujë, të kanalizimit dhe menaxhimit të mbeturinave, hapësirave publike të hapura dhe objekteve për kohë të lirë, zvogëlimin të ndotjes dhe zhurmës dhe përmirësimin të qasjes në shërbime dhe objekte. Objektivat sa i përket shëndetit njerëzor janë përfshirë në të gjitha nivelet e proceseve të planifikimit dhe vendim-marrjes. QZHM i fut çështjet e shëndetit si disa nga qëllimet më të rëndësishme për të ardhmen, derisa Strategjia e BE-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm (2001) përfshin 'Adresimin e rreziqeve për shëndetin publik, në kuadër të objektivave kryesore të tij. Në nivelin shtetëror, shëndeti është trajtuar me anë të një numri të dokumenteve, duke përfshirë Planin Hapësinor të Kosovës, i cili e përmban "Përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të shëndetit" si një nga veprimet e tij kryesore strategjike dhe për zbatimin.

Informatat bazë

Në Kosovë, të dhënat lidhur me çështjet e shëndetit janë nga viti (Tabela 10). Të dhënat në dispozicion për popullatën e Hanit të Elezit janë nga viti 2009 dhe janë rezultat i një studimi të kryer nga Komuna dhe UN-HABITATI. Popullata vlerësohet të jetë 10065 banorë me rritje të vazhdueshme që prej themelimit të fabrikës së çimentos në 1936. Vendbanimet më të populluar janë Hani i Elezit duke e përfshirë lagjen e re Seqishte me numër të përgjithshëm të 4019 banorëve, që pasohet nga Paldenica me 1876 banorë, fshati Seqishte me 1074 banorë dhe Goranca me 1026 banorë. Në Hanin e Elezit, numri i lindjeve për 1000 banorë në 2009 ishte 15,89; numri i vdekjeve për 1000 banorë në 2009 ishte 5,36 (i supozuar). Shtimi natyror i supozuar është 1,1,% i cili është nën nivelet e Kosovës. Të dhënat tregojnë se komuna ka një popullatë të re, kryesisht të përbërë nga shqiptarët (99,6%) dhe myslimanët (100%). Për sa i përket të shëndetit të lehonave dhe vdekshmërisë së foshnjave për hanin e Elezit nuk ka të dhëna në dispozicion, gjë që duhet të merret parasysh ashtu që të arrihet QZHM-ja.

Tabela 10: Treguesit demografik për Kosovën (Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës, 2010)

	1991	2000a	2000b	2001
Numri i përafërt i lindjeve për 1000 banorë	28.5	26.9	18.9	n/a
Numri i përafërt i vdekjeve për 1000 banorë	5.2	4.8	5.8	n/a
Shtimi natyror për 1000 banorë	23.3	22.1	13.1	20.1
Vdekshmëria e fëmijëve	44.0	n/a	n/a	n/a
Vdekshmëria potenciale për 1000 banorë	n/a	n/a	33	28.7

Burimi i të dhënave: UNICEF, 2000a; UNFPA/IOM, 2000b; WHO, 2001. Tabela me informata është marrë nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor të UNDP (2002).

Raporti i Drejtorisë për Shëndetësi të Hanit të Elezit thekson se në vitin 2007 sistemin e kujdesit shëndetësor e kanë vizituar 52 195 pacientë në vit (143 në ditë); 53 290 pacientë në vit (146 në ditë) në vitin 2008, 53 655 pacientë në vit (147 në ditë) në vitin 2009. Po ashtu, raporti tregon se numri mesatar i mjekëve për 1000 banorë është 0,59 kurse i infermierëve 1,49 për 1000 banorë, që është nën mesataren e vendit dhe shumë nën mesataren e vendeve fqinje.

7.8.2. Zhurma

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Ekziston një numër i Direktivave të BE-së në fuqi që kontrollojnë zhurmën nga burimet e transportit, për shembull nga automjetet dhe makineritë e jashtme, ose Direktiva e BE-së 2002/49/EC (Direktiva për Zhurmën në Mjedis) e cila ka të bëjë me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis. Ajo synon ta përkufizojë një qasje të përbashkët në tërë Bashkimin Evropian për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar efektet e dëmshme të zhurmës në mjedis nga trafiku rrugor, hekurudhor dhe ajror dhe nga industria. Deri në vitin 2007 është dashur të përgatiten hartat strategjike për zhurmën dhe deri në 2008 është dashur të hartohen planet e veprimit për mënyrën e zvogëlimin të zhurmës në mjedis sipas nevojës. Në kontekstin shtetëror, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës e përcakton Planin e Veprimit Mjedisor të Kosovës si një masë e cila mund të shfrytëzohet për minimizimin e ndikimeve të dëmshme të zhurmës. Po

ashtu, ai e thekson përgjegjësinë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar monitorimin e niveleve të zhurmës dhe që mbledhja e të dhënave të cilat do të jenë pjesë e Sistemit për Mbrojtjen e Mjedisit. Plani Hapësinor i Kosovës thotë se “hulumtimet tregojnë që pesha e zhurmës ndikon në shëndetin njerëzor, pagjumësinë dhe deri te sëmundjet kardiovaskulare”. Raporti përmend se, megjithëqë nuk ekziston sistemi për monitorimin e zhurmës në Kosovë, ajo duket të jetë shumë e lartë në të gjitha mjediset. Plani Hapësinor i Kosovës përcakton se duhet ndërtuar rripa të gjelbër në të dyja anët e autostradave për ta mbrojtur mjedisin nga zhurma dhe gazrat që lirohen nga automjetet.

Informatat bazë

Sistemi për monitorimin e ndotjes nga zhurma nuk ekziston. Raporti i PZHK-së thekson se burimet kryesore të zhurmës janë rruga Prishtinë-Shkup, hekurudha Fushë Kosovë-Shkup (ku të dyja kalojnë nëpër qytet), si dhe nga fabrika e çimentos “Sharrcem” dhe gurëthyesi pranë vendbanimit në lagjen Kashan të Paldenicës.

7.8.3. Banimi

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

PZHQM i përcakton një numër të objektivave dhe koncepteve të përbashkëta për t’u miratuar në planet hapësinore shtetërore, rajonale dhe lokale. Një prej qëllimeve kryesore të Kohezionit ekonomik dhe shoqëror, dhe banimit luan rol të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi. Dokumenti thekson se “e ardhmja e fshatrave dhe qyteteve në BE varet nga luftimin i varfërisë në rritje, përfshirja shoqërore dhe frenimin e humbjes së funksioneve të caktuara urbane. Rindërtimi i zonave të lëna pas dore dhe tokat industriale të braktisura, si dhe një ofertë e ekuilibruar për banim jo të shtrenjtë dhe me cilësi të lartë në zonat urbane duhet të promovohen”. Orientimet kryesore kombëtare lidhur me sigurimin e banimit të ri i gjejmë në Planin Hapësinor të Kosovës, i cili banimin dhe politikat e tij i konsideron se janë “problemet më thelbësore për zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe politik të vendit”, dhe e thekson “rëndësinë e krijimit të mekanizmave që do të ofrojnë një nivel adekuat të kushteve të banimit për të gjithë, veçanërisht për kategoritë shoqërore të rrezikuara”. Plani Hapësinor i Kosovës vlerëson se faktorët kryesor të kërkesave të fundit për banim janë të ndërlidhur me migrimin e familjeve drejt qyteteve të mesme dhe të mëdha.

Informatat bazë

Tabela 11: Treguesit e banimit

	Kosova 2000	Komuna e Hanit të Elezit 2009
Banimi individual (%)	93.7	99
Banimi kolektiv (%)	6.23	1
Sipërfaqja e banimit për kokë banori (m2)	18.65	n/a
Mesatarja e anëtarëve të familjes	6.5	6.77

Burimi i të dhënave: Plani Hapësinor i Kosovës; PZHK i Hanit të Elezit (2010).

Të dhënat për hapësirën dhe kushtet e banimit dhe çmimet mesatare të shtëpive aktualisht nuk ekzistojnë. Komuna e ka identifikuar një vendbanim joformal që daton nga vitet 1970ta (Bravet, 5 ha). Megjithatë, si kriter për vlerësimin e mungesës së cilësisë së banimit, QZHM-ja e shqyrton të paktën një nga katër karakteristikat në ekonomitë familjare: (a) mungesën e qasjes në furnizimin e duhur me ujë; (b) mungesën e qasjes në kanalizimin e duhur; (c) mbipopullimi (3 ose më shumë persona në një dhomë); dhe (d) banesat e ndërtuara me materiale jo të forta/qëndrueshme.

7.8.4. Qasja

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

PZHQM i përcakton një numër të objektivave dhe koncepteve të përbashkëta për t’u miratuar në planet hapësinore shtetërore, rajonale dhe lokale. Një prej qëllimeve kryesore është “Kohezioni ekonomik dhe shoqëror” dhe qasja (në shërbime dhe punësim) luan rol të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi. Strategjia e BE për Zhvillim të Qëndrueshëm, po ashtu, i referohet qasjes, me synim të përmirësimit të

sistemeve të transportit dhe menaxhimit të shfrytëzimit të tokës dhe sigurimit të qasjes së lehtë në shërbime duke i përfshirë spitalet, në të cilën transporti publik dhe planifikimi për shfrytëzimin e përzier luajnë një rol të rëndësishëm. Plani Hapësinor i Kosovës e përfshin Hanin e Elezit në zonën e Verdhë (urat e Kosovës), si dhe e përmend rëndësinë e zhvillimit të lidhjeve efikase ndër-urbane me zonat tjera, në veçanti nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës (asaj rrugore, hekurudhore, ICT).

Informatat bazë

PZHK-ja i ofron këta tregues: Përçindja e rrugëve që kanë nevojë për riparime është 84%. Po ashtu, përveç qendrës së qytetit nuk ka ndriçim të rrugëve. Hekurudha aktualisht është duke u keqpërdorur dhe rënia e numrit të udhëtarëve ka sjellë deri te zvogëlimi i numrit të qarkullimit, i cili tani bëhet vetëm një herë në ditë për në Shkup, kurse tri herë në ditë nga Fushë Kosova. Zyrtarisht kjo është forma e vetme e transportit publik në komunë. Transporti rural bëhet me kombi-busa për nxënësit, por raporti i PZHK-së e përmend nevojën për përmirësimin e këtij shërbimi, veçanërisht përkitazi me qasjen e nxënësve në shkollën e Kaçanikut. Shërbimet ekzistuese të telekomunikacionit, sipas Komunës, kanë qenë në dispozicion për ish-ndërmarrjet shoqërore dhe nuk ka funksionuar për banorët. Kohëve të fundit janë bërë punë për instalimin e sistemeve digjitale të telefonisë dhe lidhjeve të internetit. Ky rrjet tashmë i shërben qendrës së qytetit, industrisë dhe Doganës. Në bazë të profilit të PZHK-së, rrjeti tani është duke u shtrirë në Paldenicë, Dimcë dhe Secishtë. Territorin e Hanit të Elezit e mbulojnë sinjalet e dy kompanive kosovare të telefonisë mobile dhe atyre nga sistemi i telefonisë mobile të IRJM-së.

7.8.5. Margjinalizimi shoqëror

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

QZHK-ja e përcakton qëllimin e çrrënjosjes së varfërisë së skajshme. PZHQM i përcakton një numër të objektivave dhe koncepteve të përbashkëta për t'u miratuar në planet hapësinore shtetërore, rajonale dhe lokale. Një prej qëllimeve kryesore është "Kohezioni ekonomik dhe shoqëror", ku integrimi shoqëror luan rol të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi. Plani Hapësinor i Kosovës e përmend objektivin e "Zvogëlimin të shkallës së varfërisë veçanërisht të theksuar në zonat rurale".

Informatat bazë

Studimi në terren i PZHK-së tregon se 17 % e popullatës jeton në varfëri të skajshme me më pak se 0.60 € në ditë, kurse 56% e popullatës jeton me 1 € në ditë. Këto shifra janë nën mesataren e vendit, sipas Vlerësimit të Varfërisë nga Banka Botërore, 37% e popullatës në Kosovë është klasifikuar si "e varfër", që jeton me më pak se 1.42 € në ditë, kurse 15% janë nën nivelin e varfërisë së skajshme me 0.93 € në ditë. Hani i Elezit e sheh marginalizimin shoqëror të ndërlidhur me papunësinë (i renditur në 67% në komunë) dhe në mungesën e qasjes në nevojat themelore njerëzore si uji i pastër. Shkalla e papunësisë në komunë është shumë më e lartë se shkalla e papunësisë në Kosovë prej 44.4%. Megjithatë, shifrat e papunësisë nuk mund t'i masin sektorët e punësimit joformal dhe se nuk ka të dhëna empirike të rritjes së niveleve të krimit ose të destabilitetit shoqëror, gjë që është një trend pozitiv dhe vlen të përmendet: solidariteti dhe ndjenja e identitetit shoqëror duket se mbizotërojnë dhe janë baraspeshim i mungesës së nevojave themelore.

7.8.6. Rekreacioni, sporti dhe koha e lirë

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Mënyra në të cilën trajtohen hapësirat publike në kuadër të shfrytëzimit të tokës është jetike për angazhimin qytetar dhe zhvillimin urban. PZHQM e përmend këtë nevojë për ta adresuar përmirësimin e cilësisë së mjedisit publik në shumë zona të qytetit. Pa të, do të kishte një "ndikim ekonomik për shkak të humbjes së atraktivitetit dhe zvogëlimit të investimeve, punësimit dhe burimeve financiare të komunës". Po ashtu, PZHQM e spikat vlerën e zonave rurale sa i përket ofrimit të rekreacionit dhe rehatisë gjatë kohës së lirë dhe ofrimit të baraspeshimit me aktivitetet urbane. Udhëzimet kombëtare në kuadër të Planit Hapësinor të Kosovës, e përmendin nevojën për t'i siguruar shërbimet publike në dobi të qytetarëve, duke synuar rritjen e cilësisë së jetës.

Informatat bazë

Në Hanin e Elezit nuk ka asnjë muze dhe pak mundësi për angazhim qytetar në veprimtaritë kulturore. Sipas PZHK-së, ekzistojnë aktivitete sportive që organizohen në kuadër të strukturave shkollore, një klub sportive i të rinjve me një fushë futbollit dhe një shtëpi kulture (ky organizohen disa aktivitete). Nuk ka të dhëna për shfrytëzimin e hapësirave publike të hapura, edhe pse është e dukshme se popullata i shfrytëzon intensivisht hapësirat publike (formale dhe joformale) për rekreacion (si fëmijët që i shfrytëzojnë hapësirat e rrugëve për rrëshqitje në borë) dhe për aktivitete ditore (ecja për në shkollë ose për blerje).

7.8.7. Sektori i arsimit

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Një prej PZHQ-ve është arritja e arsimit fillor për të gjithë. PZHQM e ka përcaktuar “Kohezionin ekonomik dhe shoqëror” si njërin prej qëllimeve kryesore të tij, ku arsimi zë vend të lartë në agjendë. Plani Hapësinor i Kosovës e përmend “rënien e interesit të rinjve për arsimin e lartë” si një prej rreziqeve kryesore në zhvillimin afatgjatë të zonës së Verdhë. Plani e vlerëson arsimin si “njërin nga përnxitësit kryesor të suksesit ekonomik, si dhe suksesit të përgjithshëm në shoqëritë moderne”, i rëndësishëm në “arritjen e zhvillimit të barabartë, krijimit të një shoqërie përfshirëse, ku të gjithë qytetarët kanë mundësi dhe iniciativë për të marrë pjesë me kapacitetet e tyre të plota në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit”, si dhe nevojën për zbatimin e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe qasjes në arsimin e mesëm dhe të lartë.

Informatat bazë

Raporti i PZHK-së e jep një përqindje prej 30% të popullatës në grupmoshën 0-14 (3019 banorë). Në komunë aktualisht nuk ka kopsht fëmijësh. Në Hanin e Elezit raporti nxënës-mësues nëpër klasë në ciklet e ulëta është 30,15, mbi mesataren e vendit prej 23,97; raporti nxënës-mësues në shkollat fillore dhe të mesme të ulët është 22,40, mbi mesataren e vendit prej 18,34. Në Hanin e Elezit raporti nxënës-mësues nëpër klasë në shkollat e mesme është 33,5, mbi mesataren e vendit prej 31,65; raporti nxënës-mësues në shkollën e lartë është 21,20, mbi mesataren e vendit prej 20,1.

Tabela 12: Nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm

KLASA	Nr i PARALELEVE	NUMRI I NXËNËSVE		
		F	M	Gjithsej
Parashkollor (5-6 vjeç)	4	67	67	134
1	6	71	85	156
2	7	57	74	131
3	7	78	99	177
4	7	97	72	169
5	6	64	84	148
6	6	78	81	159
7	6	80	82	162
8	6	85	111	196
Faza kryesore 9	6	65	100	165
Klasat e kombinuara	7	30	39	69
Nevoja të veçanta	0	0	0	0
Gjithsej (T)	68	772	894	1666

Burimi: Raportet për 2009/2010 nga Drejtorja për Arsimit, Kulturë dhe Sport, Komuna e Hanit të Elezit

Tabela 13: Studentët në shkollë të lartë

KLASA	Nr i PARALELEVE	NR I STUDENTËVE
-------	-----------------	-----------------

		F	M	T
10	5	87	96	183
11	3	58	60	118
Faza kryesore 12	5	68	88	156
13	0	0	0	0
Gjithsej (T)	13	213	244	457

Burimi: Raportet për 2009/2010 nga Drejtoria për Arsim, Kulturë dhe Sport, Komuna e Hanit të Elezit

Tabela 14: Studentët në arsimin e lartë

STUDENTËT NË ARSIMIN E LARTË	GJINIA		
	F	M	GJITHSEJ
Nr i studentëve	37	68	105

Burimi: Studimi i vitit 2009

Në bazë të informatave nga studimin në terren, pjesa më e madhe e popullatës në Hanin e Elezit e kanë kryer arsimin fillor dhe të mesëm. (36% posedon arsimin fillor dhe 22% arsimin e mesëm), kurse të paarsimuar janë rreth 8%. 3% e popullatës posedon arsim të lartë (magjistraturë 0.2%).




Foto 6: Shkalla e kualifikimit të popullatës

Burimi: Studimi i PZH 2009

7.8.8. Veprimtaritë ekonomike

Marrëdhënia me planet dhe programet tjera

Ripërtëritja ekonomike luan një rol të rëndësishëm për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Dy nga tri qëllimet kryesore të PZHQM-së janë veçanërisht të ndërlidhura me çështjet ekonomike: arritja e kohezionit ekonomik në të gjitha rajonet e Evropës; si dhe të promovohet një konkurrencë më e ekuilibruar në territorin evropian. Kjo pikë miratuar gjithashtu nga Plani Hapësinor i Kosovës, duke thënë se në “zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, veprimtaritë industriale, komerciale dhe shërbyese janë jetike në krijim e mundësive për banorët për të fituar të ardhura”. Plani propozon zhvillimin e shërbimeve komerciale, agro-industriale dhe turistike për zonën e Verdhë, e cila e përfshin komunën e Hanit të Elezit.

Informatat bazë

trashëgimia, shëndeti, përfshirja dhe barazia shoqërore, banimi dhe marginalizimi shoqëror. Tabela 16 i paraqet lidhjet ekzistuese dhe përplotësimet ndërmjet qëllimeve të PZHK-së dhe objektivave të VSM-së. Kjo tabelë mundëson një pasqyrim më të qartë të përplasjeve të mundshme në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, të cilat mund të dalin nga veprimtaritë e reja industriale, urbane, rurale dhe turistike.

PZHK-ja është analizuar përkitazi me ndryshimet e parashikuara dhe ndikimit të tyre në standardin bazë të krijuar. Krahas vlerësimit të ndikimeve të PZHK-së në mjedis, VSM-ja i shqyrton edhe ndikimet dytësore, kumulative dhe sinergjike që mund të dalin nga zbatimi i propozimit. Ndikimet do të analizohen më tej për sa i përket shkallës kohore (lidhur me efektet afat shkurta, mesme dhe gjata), reverzibilitetit, madhësisë, vlerës së tyre dhe rrezikshmërisë së zonës që ka të ngjarë të preket dhe efektet ndërkuftare. Efektet e rëndësishme të parashikuara në mjedis janë paraqitur më hollësisht në vijim.

**ÇËSHTJET MJEDISORE
 OBJEKTIVAT E VSM**

- MBROJTJA DHE PËRMIRËSIMI I BIODIVERSITETIT
- PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË AJRIT NË ZONAT URBANE
- PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË UJIT DHE KUFIZIMI I SHPENZIMIT TË UJIT
- MINIMIZIMI I HUMBJES SË TOKAVE TË VLEFSHME
- SIURIMI QË ZHVILLIMI I RI TË MOS I RRIË GS-të
- ZVOGËLIMI I EMETIMEVE TË CO2 DHE GS-ve TJERA
- SHFRYTËZIMI EFIKAS I BURIMEVE NATYRORE
- MIRËMBAJTJA DHE PËRMIRËSIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE
- KONSERVIMI DHE PËRMIRËSIMI I PEIZAZHIT DHE PAMJES SË QYTETIT
- INKURAJIMI I MËNYRËS SË SHËNDETSHEM TË JETESËS
- PROMOVIMI I BARAZISË DHE PËRFSHIRJES SHOQËRORE
- SIGURIMI I QASJES NË BANIM TË MIRË PËR TË GJITHË
- ZVOGËLIMI I MARGJINALIZIMIT

	PROMOVIMI I ZHVILLIMIT KOMPAKT	PËRKUFIZIMI I LOKACIONEVE DHE BURIMEVE PËR ZHVILLIMIN KOMUNAL	MBROJTJA E TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE	IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE PËR BASHKËPUNIM NDËRKUFITAR	PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK (VEPRIMTARITË INDUSTRIALE, RURALE DHE TURISTIKE)	KRUIIMI I STRUKTURËS URBANE KOMBËTARE TË INTEGRUAR (INFRASTRUKTURA FIZIKE, SISTEMET E LËVIZSHMËRISË DHE TRANSPORTIT)	PROMOVIMI I KOHEZIONIT SHOQËRORE (PËRMIRËSIMI I SHËRBIEMEVE SHOQËRORE DHE STRUKTURIMI I ZONAVE KRYESORE URBANE)	ZVOGËLIMI DHE ZBUTJTA E KATASTROFAVE (RIGJALLËRIMI URBAN, RIPYLLËZIMI, BIODIVERSITETI DHE RRJETET EKOLOGJIKE)	PËRMIRËSIMI I BANIMIT DHE KUSHTEVE PËR JETË PËR TË GJITHË
MBROJTJA DHE PËRMIRËSIMI I BIODIVERSITETIT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E DOBËT	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË AJRIT NË ZONAT URBANE	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË UJIT DHE KUFIZIMI I SHPENZIMIT TË UJIT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E DOBËT	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
MINIMIZIMI I HUMBJES SË TOKAVE TË VLEFSHME	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E DOBËT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
SIURIMI QË ZHVILLIMI I RI TË MOS I RRIË GS-të	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
ZVOGËLIMI I EMETIMEVE TË CO2 DHE GS-ve TJERA	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E DOBËT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
SHFRYTËZIMI EFIKAS I BURIMEVE NATYRORE	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
MIRËMBAJTJA DHE PËRMIRËSIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE
KONSERVIMI DHE PËRMIRËSIMI I PEIZAZHIT DHE PAMJES SË QYTETIT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË
INKURAJIMI I MËNYRËS SË SHËNDETSHEM TË JETESËS	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË
PROMOVIMI I BARAZISË DHE PËRFSHIRJES SHOQËRORE	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE	NUK KA LIDHJE	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E FORTË	NUK KA LIDHJE	LIDHJE E BUTË
SIGURIMI I QASJES NË BANIM TË MIRË PËR TË GJITHË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE	NUK KA LIDHJE	NUK KA LIDHJE	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË
ZVOGËLIMI I MARGJINALIZIMIT	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	NUK KA LIDHJE	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E FORTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË	LIDHJE E BUTË



Tabela 16: Përputhjet /përplasjet ndërmjet objektivave të PZHK-së dhe VSM-së

9.1. Cilësia e ajrit

Efektet kumulative nga aktivitetet e reja industriale dhe kushtet e reja për transportin e mallrave parashihen që të kenë një ndikim të rëndësishëm negativ në cilësinë e ajrit. Promovimi i nën-qendrës së re urbane në Gorancë, në kuptimin afatgjatë mund ta rris varësinë nga automjetet dhe njëkohësisht të rezultojë me ndikime negative dytësore në cilësinë e ajrit. Mirëpo, ripyllëzimi i planifikuar (krahas me kontrollimin e prerjeve ilegale të drurit) dhe krijimin e një rripi të gjelbër për mbrojtje nga industria e çimentos, duke e themeluar edhe sistemin për monitorimin e ajrit, do të ndihmojnë në ekuilibrimin dhe kontrollimin e këtyre ndikimeve negative. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, përmes asfaltimit të disa rrugëve të kësaj komune, po ashtu do të përmirësojnë kushtet për udhëtim me veturë, duke rezultuar me një efekt të mundshëm dytësor dhe afatgjatë të modelit të shtrirjes. Plani i paraparë për transport, duke e përfshirë edhe stacionin e ri të autobusëve dhe inkurajimin për mënyrat tjera të transportit duke përfshirë edhe shtigjet për këmbësorë dhe shtigjet për biçikleta do të ndikojnë pozitivisht në cilësinë e ajrit. Nëse në fazën e hershme të zbatimit, realizimi bëhet në mënyrë të racionalizuar, atëherë ky sistem i transportit mund të kontrollojë varësinë e padëshiruar për vetura dhe modelin e shtrirjes.

9.2. Biodiversiteti

Efektet kumulative të zonifikimit të tokës dhe inkurajimi i veprimtarisë bujqësore parashihen të kenë një ndikim dytësor mbi biodiversitetin, përmes aktiviteteve të blegtorisë, shpeztarisë dhe bletarisë sikurse edhe me paraqitjen e trendëve të reja bujqësore të cilat do të sjellin ndryshime në ekuilibrin ekologjik. Mbrojtja e hapësirave pyjore, ripyllëzimi, rregullimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimcë, krahas veprimeve të dekontaminimit dhe fuqizimit të zbatimit të masave nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, do të kenë një ndikim pozitiv dhe të përhershëm në mjedis. Ky efekt pozitiv do të jetë i dukshëm në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, ndërsa rezultatet më të dukshme do të jenë të periudhës afatgjatë.

9.3. Cilësia e ujit

Efektet kumulative nga zhvillimi i ri industrial parashihen që të kenë ndikim negativ në cilësinë e ujit. Mirëpo, zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, dekontaminimi i lumit Lepenc nga asbesti, dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe përroskës Dimcë, rregullat për zonifikimin e tokës, krijimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe i impianteve për pastrimin e ujërave të zeza parashihen që të kenë një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në cilësinë e ujit.

9.4. Toka

Efektet kumulative nga zhvillimi i bujqësisë parashihen të kenë ndikim negativ në tokë. Efektet kumulative nga dekontaminimi i shtretërve të lumenjve, dekontaminimi i tankeve të ish-ushtrisë brenda objektivit të PZHK-së për rigjallërimin e mjedisit dhe krijimi i rrjetit të kanalizimit do të kenë një ndikim pozitiv afatgjatë për tokën. Efektet sinergjike pozitive për zbatimin e këtyre masave do të rezultojnë nga themelimi i një kompanie publike për menaxhimin e mbeturinave.

9.5. Ndryshimet klimatike

Efektet kumulative nga industria (përhapja e industrive të reja, hapësirave për parkim dhe organizimi i transportit të mallrave) dhe nga mjedisi rural (veprimtaria e blegtorisë) dhe zhvillimi i propozuar, do të kenë ndikim negativ afatshkurtër në kuptim të shtimit të emetimit të GS-ve. Përmirësimet në infrastrukturën rrugore dhe ndërtimi i nën-qendrës urbane do të rezultojnë në shtimin e emetimit të CO2 për shkak të rritjes së paraparë të transportit privat. Mirëpo, propozimi për një sistem të transportit efikas, krahas planit për ripyllëzim, mbrojtjen e hapësirave pyjore dhe masave të propozuara për parandalimin e

shpyllëzimit ilegal, do të kenë efekte të rëndësishme pozitive në mjedis për një periudhë afatgjatë. Për më tepër, propozimi për themelimin e një sistemi për monitorimin e ajrit, do të mundësojë zbatimin e plotë të këtyre masave dhe vazhdimësinë e tyre në mënyrë të kënaqshme. Vlerësimi i ndikimit në Mjedis (VNM) për veprimtaritë e reja industriale, në kuptimin afatgjatë do të ndihmojë në zvogëlimin e këtyre emetimeve, kryesisht përmes investimeve për energji të pastër dhe procedurave për izolimin e karbonit.

9.6. Burimet natyrore

Propozimi për zhvillimin industrial, rural dhe urban që rezulton me rritje demografike, po ashtu do të rris kërkesën për burime natyrore, d.m.th., kërkesa për ushqim dhe materiale. Punimi i tokës dhe transporti do të kenë një ndikim të rëndësishëm në emetimet e GS-ve dhe në kërkesat për burime natyrore. Burimet e energjisë së ripërtëritshme dhe sistemet efikase për transport mund të kompensojnë kërkesat në rritje dhe të sigurojnë një të ardhme me një klimë stabile dhe një model për shpenzimin e energjisë. Zvogëlimi i kërkesës për shfrytëzuesit e fundit (për ndërtesa dhe transport) do të ketë ndikim direkt në emetime dhe një ndikim në GS të nevojshme për qëllime industriale dhe për pajisje. Të gjitha strategjitë e propozuara për mbrojtjen e mjedisit (mbrojtja e hapësirave pyjore, ripyllëzimi, dekontaminimi i lumenjve dhe hapësirave të shfrytëzuara nga ish-ushtria, etj.) do të kenë një ndikim kumulativ direkt e të rëndësishëm në burimet natyrore.

9.7. Trashëgimia

Turizmi dhe zhvillimi urban i ri në nën-qendrën e Gorancës do të ketë ndikim direkt mbi trashëgiminë. Ekziston rreziku që këto masa të kenë ndikim negativ të përhershëm në trashëgiminë arkitekturore përmes humbjes së autenticitetit. Masat për shmangien e këtij ndikimi potencial negativ janë dhënia e prioritetit për veprimet strategjike, sigurimi i inventarizimit të arkitekturës vendore, si një hap i parë, pastaj angazhimi i partneriteteve shkencore dhe akademike me qëllim të ndërgjegjësimit mbi rreziqshmërinë dhe vlerën e kësaj trashëgimie dhe më së shumti për themelimin e planit të paraparë për konservim, i cili në mënyrë strategjike do t'i drejtojë të gjitha zhvillimet e reja potenciale në një fazë të hershme duke mos e rrezikuar më tej trashëgiminë kulturore ekzistuese. Pritet që këto masa do të kenë një ndikim pozitiv afatgjatë në mjedisin urban.

9.8. Shëndeti

Efektet kumulative nga Mbrojtja e Mjedisit dhe Rigjenerimi, përmirësimet në institucionet shëndetësore (ndërtimi i anekseve në qendrat për mjekësi familjare dhe përmirësimi i shërbimeve në nën-qendrën e Gorancës) dhe i aktiviteteve sportive, krahas me masat për sigurimin e infrastrukturës urbane (si, sistemi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit) janë paraparë që të kenë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në shëndetin e njeriut. Ajo që është më e rëndësishme është se masat të cilat sigurojnë mekanizmat ekzistues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit duhet të zbatohen në praktikë dhe kjo do të rezultojë me një përmirësim afatgjatë të çështjeve të lidhura me shëndetin. Rritjes së aktivitetit industrial duhet t'i paraprijë një VNM për përshtatjen e të gjitha propozimeve për zhvillimin e teknologjive të reja, si bie fjala, izolimi i karbonit, me qëllim të parandalimit të ndikimeve negative në shëndetin e njerëzve.

9.9. Përfshirja dhe barazia shorëqore

“Qëndrueshmëria shoqërore është një koncept i gjerë dhe sfidues. Një pjesë e këtij koncepti është që grupeve të ndryshme në shoqëri t’u jepen mundësi të barabarta për qasje në hapësirën e përbashkët të qytetit dhe lëvizjen përreth qytetit. Barazia vjen në shprehje edhe më shumë kur njerëzit mund të ecin dhe të ngasin biçikletën në kombinim me transportin publik. Njerëzit që nuk posedojnë vetura duhet të kenë qasje në atë çfarë ofron qyteti dhe të kenë edhe mundësi që gjatë ditës të mos jenë të kufizuar për shkak të opsioneve të pakta të transportit.” (Gehl 2010)

Ekziston rreziku që me propozimin për zhvillimin urban në Gorancë do të ketë hapësirë për ndarje shoqërore dhe qasje jo të barabartë për nevojat bazike. Për të parandaluar këtë, PZHK ka propozuar një numër të shërbimeve të reja arsimore, sociale, shëndetësore dhe kulturore. Mirëpo, të gjitha këto veprime kërkojnë fonde dhe ekziston rreziku që ato të mos realizohen në mënyrë të plotë. Në këtë rast, ekziston një ndikim afatmesëm i parashikuar në kuptim të përfshirjes shoqërore dhe të barazisë. Masat për promovimin e përfshirjes shoqërore janë propozuar në strategji me qëllim të krijimit të sistemit të transportit publik i cili po ashtu duhet të jetë prioritet në kuptimin e arritjes së përfshirjes e të barazisë shoqërore. Këto veprime kërkojnë kohë, mjete dhe efektivitet, ndërsa në rast të mos zbatimit të drejtë të tyre, ato do të prodhojnë ndikim negativ mbi barazinë shoqërore. Kështu, është me rëndësi që zhvillimit publik t'i paraprijnë investimet private në sferën e banimit, ndërsa mundësitë për financim duhet të gjenden në një fazë më të hershme të këtij procesi.

9.10. Banimi

Efektet kumulative të masave për promovimin e shërbimeve publike (si, rrjeti i energjisë elektrike) dhe të infrastrukturës (si, rrjeti i kanalizimit dhe i ujësjellësit) do të kenë një ndikim pozitiv për një periudhë kohore afatmesme. Veç kësaj, masat për promovimin e banimit social, në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu janë paraparë të kenë një ndikim pozitiv për një periudhë kohore afatmesme.

9.11. Margjinalizimi shoqëror

Krijimi i mundësive për punësim në sektorin e industrisë, bujqësisë dhe turizmit do të ketë një ndikim pozitiv në zvogëlimin e margjinalizimit shoqëror. Efektet sinergjike që paraqiten nga bashkëpunimi ndërkuftar po ashtu do të ketë ndikim në margjinalizimin shoqëror, sigurimin e mundësive për qasje dhe përmirësim të aktiviteteve shoqërore, arsimore dhe kulturore. Ekzistojnë edhe efektet pozitive dytësore që dalin nga përmirësimi i programuar i institucioneve dhe shërbimeve publike si, arsimit, shëndetësisë, sportit dhe aktiviteteve kulturore. Siç edhe u tha në pikën 9.9, efektet kumulative të përmirësimit të hapësirës dhe transportit publik po ashtu do të kenë një ndikim pozitiv në përfshirjen shoqërore dhe qasjen në mallra dhe shërbime.

10. Zbutja dhe përmirësimi

Masat zbutëse janë masa të cilat konsiderohen të domosdoshme për parandalimin, zvogëlimin dhe aty ku është e mundur përmirësimin ose kompensimin e çfarëdo ndikimi të pafavorshëm të veprimeve të planifikuara. Në këtë kapitull, ne do të hulumtojmë të gjitha mundësitë e shqyrtuara në PZHK dhe do të paraqesim masa të tjera për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative në mjedis, me qëllim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

“Ndërsa krijimi i vendeve të punës është diçka qenësore, një zgjidhje kuptimplotë e problemeve të sotme thjeshtë nuk qëndron vetëm në ristartimin e makinës së shpenzimit. Kjo qasje çoi deri te degradimi dhe varfërimi i burimeve natyrore të planetit që nuk mundi të përmbushte nevojat themelore të shumicës së njerëzimit. Kriza aktuale ofron një mundësi të vetme për nisjen e një themeli për një ekonomi globale të gjelbër dhe më të drejtë.” (The Worldwatch Institute 2010a)

Me rritjen e numrit të ekonomive familjare, do të rritet edhe shpenzimi i energjisë së përgjithshme. Kërkesa e madhe për energji për aktivitete individuale duhet të kompensohet me masat për shtimin e efikasitetit të energjisë për automjetet dhe ndërtesat. Teknologjitë e gjelbra për zhvillim industrial dhe bujqësor dhe institucionet publike, do të luajnë një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e ndikimit nga emetimi i karbonit. Kërkesa e zvogëluar për shfrytëzuesit e fundit, do të ketë ndikim në emetimet GS që

dalin nga aktivitetet industriale, publike dhe ato të transportit. Ripyllëzimi i propozuar po ashtu paraqet një hap të rëndësishëm për balancimin e GS të emetuara për shkak të zhvillimit industrial.

Një masë tjetër e rëndësishme e paraparë në PZHK është sigurimi që investitorët industrialë të respektojnë Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, pra pjesa që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, që do të paraqes masat për zvogëlimin e emetimeve të GS, si bie fjala akumulimi dhe izolimi i karbonit. Dispozitat zbatuese duhet të përfshijnë një hapësirë për aktivitetet industriale, duke përkujtuar se themelimit të gjitha aktiviteteve të reja industriale duhet t'i paraprijë një VNM dhe të jenë tërheqëse për industritë kreative me shpenzim të ulët të energjisë, kryesisht në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe të riciklimit. Komuna duhet të ndërmerri hapa që mundësojnë partneritete inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin industrial.

Veprimtaritë bujqësore kanë një rol vendimtar në ndryshimet klimatike përmes blegtorisë që siguron 51% të emetimit global të CO₂ (Goodland and Anhang 2009). Si një masë zbutëse, bujqit duhet të kompensohen për modifikimin e praktikave të tyre bujqësore dhe promovimin e bujqësisë rigjeneruese (izolimi i karbonit).

Turizmi dhe zhvillimi i ri urban paraqesin ndikime sfiduese mbi trashëgiminë. Masat e parapara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do të jenë të pamjaftueshme nëse ato nuk merren seriozisht përmes njohurive shkencore dhe në një fazë të hershme të këtij procesi. Ekziston një rrezik i lartë që turizmi dhe zhvillimi i ri i propozuar të ketë një ndikim të përhershëm negativ në trashëgiminë kulturore, duke e humbur autenticitetin e vendbanimeve nëpër fshatra. Veprimet e parapara strategjike në PZHK duhet të kenë prioritet, në mënyrë që trashëgimia arkitekturore vendore të ketë vendin e vet përpara çfarëdo veprimi zhvillimor në kontekst të fshatrave, angazhimit të partneriteteve shkencore dhe akademike për ndërgjegjësim lidhur me rrezikshmërinë dhe vlerat e kësaj trashëgimie. Njohuria për gjendjen aktuale të trashëgimisë vendore, duke përfshirë të gjitha elementet të cilat e krijojnë peizazhin e fshatit paraqet mjetin kryesor për mbështetjen e ruajtjes së këtyre vendbanimeve. Plani i Konservimit është një instrument i rëndësishëm për udhëheqjen e të gjitha veprimeve strategjike në kuadër të këtyre vendbanimeve. Ai duhet të përcillet nga ekspertët e trashëgimisë dhe si gjithëherë, përmes angazhimit të popullsisë në skemat e integruara të konservimit.

Qasja e barabartë në shërbimet publike si në arsim, shëndetësi dhe kulturë është një kërkesë qenësore për realizimin e një zhvillimi të qëndrueshëm. Krahas peizazhit të bukur dhe trashëgimisë kulturore edhe baraspesha shoqërore sot paraqet një rëndësi prej fuqive më vitale të komunës. Masat për rforcimin e përfshirjes shoqërore dhe të barazisë janë të propozuara në PZHK. Mirëpo, këto veprime (themelimi i sistemit për transportin publik dhe ndërtimi dhe përmirësimi i një numri të institucioneve publike), kërkojnë angazhime serioze në kuptim të burimeve teknike dhe financiare. Ekziston rreziku i mos implementimit të plotë për institucionet e nevojshme publike dhe sistemin e transportit, si dhe shtimin e gjasave për rritjen e zbrazëtirave shoqërore. Prandaj, është me rëndësi që investimit privat në banim t'i paraprijë zhvillimi publik (për popullatën e re në nën-qendrën e Gorancës) dhe që mundësitë për financim të këtyre veprimeve të gjinden në fazën e hershme të procesit.

Masat rregulluese duhet të ndërmerren për të siguruar që zhvillimet në banim të jenë të integruara në lagjet e frekuentuara dhe ato të zbatohen pasi të jetë realizuar plotësisht infrastruktura publike. Në këtë proces, paraqitja e vendbanimeve joformale paraqet rrezik dhe për këtë rregullimi dhe zbatimi i ligjit duhet të bëjnë përgatitjet e nevojshme. Banimi social paraqet një hap të rëndësishëm në procesin e sigurimit të qasjes së barabartë në banim. Një masë e propozuar për shmangien nga sektorizimi shoqëror është që njësitë e vogla banesore të integrohen në vendbanimet ekzistuese, duke respektuar arkitekturën vendore dhe peizazhin ekzistues sesa në importimin e modeleve të banimit të cilat shpesh nuk përkojnë me pritjet e popullatës dhe me pamjen e qytetit. Propozimi i dhënë është që të studiohen nevojat e popullatës me qëllim të gjetjes së llojeve tjera të mbështetjes shoqërore dhe përdorimin e investimeve publike aty ku është më se e nevojshme dhe krahas me këtë të sigurohen mundësi për investime private duke shfrytëzuar kështu ndërtimin nga niveli lokal. Masat për mbështetjen e ekonomisë lokale dhe mikrofinancimi duhet të studiohen në mënyrë që të promovojnë zhvillimin lokal.

Në Tabelën 17 kemi paraqitur një sintezë të vlerësimit të efekteve, duke marrë parasysh ndikimet e parapara kryesore pozitive dhe negative dhe zbutjen e masave të cilat shqyrtohen në kuadër të Planit.

Tabela 17: Sinteza e rreziqeve të vërejtura në Vlerësimin e Efekteve të Rëndësishme dhe Masave Zbutëse

	NDIKIMET NEGATIVE	NDIKIMET POZITIVE
CILËSIA E AJRIT	Aktivitetet e reja industriale dhe kushtet e reja për transportin e mallrave. Promovimi i qendrës urbane dytësore në Gorancë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore.	Ripyllëzimi i planifikuar. Mbrojtja e hapësirave pyjore. Kontrolli i shpyllëzimit ilegal. Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Krijimi i një rripi të gjelbër për mbrojtje nga industria e çimentos. Plani i transportit. Sistemi për monitorimin e ajrit.
Masat zbutëse	Zbatimi i VNM për aktivitetet e reja industriale (me promovimin e SIK). Teknologjitë e gjelbra, përdorimi dhe gjenerimi i energjisë së ripërtrishme, efikasiteti më i lartë i energjisë. Emetimi i ulët nga automjetet e transportit publik. Ripyllëzimi. Barriera-rripi i gjelbër përgjatë autostradës dhe zonave industriale. Dhënia e prioritetit për implementim me qëllim të promovimit të sistemit të transportit publik para zhvillimit të ri.	
BIODIVERSITETI	Efektet e panjohura me paraqitjen e aktiviteteve të bujqësisë, blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë.	Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore. Ripyllëzimi. Përmirësimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtratit të përroskës Dimcë. Veprimet e dekontaminimit. Zbatimi i masave nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.
Masat zbutëse	Promovimi i bujqësisë rigjeneruese (izolimi i karbonit). Ripyllëzimi. Identifikimi i zonave të biodiversitetit. Sistemi monitorues për florën dhe faunën.	
CILËSIA E UJIT	Zhvillimi i ri industrial.	Zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit. Dekontaminimi i lumit Lepenc nga asbesti. Dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtratit të përroskës Dimcë. Zonifikimi i tokës. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.
Masat zbutëse	Zbatimi i VNM për aktivitetet e reja industriale (me promovimin e SIK). Promovimi i partneriteteve inovative të lidhura me fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin e industrisë.	
TOKA	Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë.	Rigjenerimi i mjedisit. Kompania publike për menaxhimin e mbeturinave. Zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit. Dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtratit të përroskës Dimcë. Zonifikimi i tokës. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe

		kanalizimit. Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.
Masat zbutëse	Bujqësia organike e qëndrueshme. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse.	
NDRYSHIMET KLIMATIKE	Zhvillimi industrial dhe rural. Promovimi i qendrës urbane dytësore në Gorancë. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore.	Ripyllëzimi i planifikuar. Mbrojtja e mjediseve pyjore. Kontrolli i shpyllëzimit ilegal. Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Krijimi i rripit të gjelbër për mbrojtjen e mjedisit urban nga industria e çimentos dhe autostrada. Plani i transportit. Sistemi për monitorimin e ajrit.
Masat zbutëse	Zbatimi i VNM për aktivitetet e reja industriale (me promovimin e SIK). Teknologjitë e gjelbra, përdorimi dhe gjenerimi i energjisë së ripërtrishme, efikasiteti më i lartë i energjisë. Barriera-rripi i gjelbër përgjatë autostradës dhe zonave industriale. Promovimi i bujqësisë rigjeneruese (izolimi i karbonit). Ripyllëzimi. Plani i transportit. Transporti publik me automjete me emetim të ulët të gazrave. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin e industrisë. Sistemi për monitorimin e ajrit.	
BURIMET NATYRORE	Zhvillimi industrial, rural dhe urban.	Ripyllëzimi i planifikuar. Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore. Kontrolli i shpyllëzimit ilegal. Dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtratit të përroskës Dimcë. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza. Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Krijimi i rripit të gjelbër. Zonifikimi i tokës. Plani i transportit. Sistemi për monitorimin e ajrit. Kompania publike për menaxhimin e mbeturinave.
Masat zbutëse	Zbatimi i VNM për aktivitetet e reja industriale (me promovimin e SIK). Teknologjitë e gjelbra, përdorimi dhe gjenerimi i energjisë së ripërtrishme, efikasiteti më i lartë i energjisë. Promovimi i bujqësisë rigjeneruese (izolimi i karbonit). Mbrojtja e mjedisit dhe masat për rigjenerim. Plani i transportit. Transporti publik me automjete me emetim të ulët të gazrave. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin e industrisë. Sistemi për monitorimin e ajrit.	
TRASHËGIMIA	Turizmi dhe zhvillimi i ri urban në nën-qendrën e Gorancës.	Plani i konservimit. Inventarizimi i trashëgimisë.
Masat zbutëse	Caktimi i prioritetit për veprimet strategjike. Plani i konservimit.	

Inventarizimi i trashëgimisë. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse.		
SHËNDETI	Zhvillimi industrial.	Përmirësimet në objektet shëndetësore. Përmirësimet në objektet sportive. Ripyllëzimi i planifikuar. Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore. Kontrolli i shpyllëzimit ilegal. Dekontaminimi i shtratit të lumit Lepenc dhe shtratit të përroskës Dimçë. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza. Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit. Krijimi i rripit të gjelbër. Zonifikimi i tokës. Plani i transportit. Sistemi për monitorimin e ajrit. Kompania publike për menaxhimin e mbeturinave.
Masat zbutëse	Zbatimi i VNM për aktivitetet e reja industriale. Barriera-rripi i gjelbër përgjatë autostradës dhe zonave industriale. Mbrojtja e mjedisit dhe masat për rigjenerim. Plani i transportit. Promovimi i partneriteteve inovative në fushat shkencore përkatëse dhe me sektorin e industrisë. Sistemi për monitorimin e ajrit.	
PËRFSHIRJA DHE BARAZIA SHOQËRORE	Nën-qendra në Gorancë.	Krijimi dhe përmirësimi i shërbimeve dhe objekteve arsimore, sociale, shëndetësore dhe kulturore. Sistemi i transportit publik.
Masat zbutëse	Dhënia e prioritetit për veprimet strategjike.	
BANIMI		Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ndërtimi i rrjetit elektrik. Banimi social.
Masat zbutëse	Nuk janë të nevojshme.	
MARGJINALIZI MI SHOQËROR		Krijimi i mundësive për punësim në sektorin e industrisë, bujqësisë dhe turizmit. Krijimi dhe përmirësimi i shërbimeve dhe objekteve arsimore, sociale, shëndetësore dhe kulturore. Sistemi i transportit publik. Bashkëpunimi ndërkufitar.
Masat zbutëse	Nuk janë të nevojshme.	

11. Paqartësitë dhe rreziqet

Sfidat e parapara përshijë vështirësitë në kanalizimin e fondeve dhe delegimin e autoritetit për fuqizim; forcimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore; krijimi i mundësive të reja për jetesë dhe punësim; ndërtimi i masave për zvogëlimin e ndikimit të ardhshëm të katastrofave në pyje, sektorët e bujqësisë; sigurimi i kanalizimit të resurseve drejt shërbimeve që e avancojnë zhvillimin njerëzor; sigurimi që vlerësimi strategjik mjedisor për Propozim planin zhvillimor komunal të Hanit të Elezit |

veprimtaritë industriale ekzistuese dhe të parapara t'i respektojnë rekomandimet mjedisore dhe të marrin pjesë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit. Meqë popullata vetvetiu është shumë e vogël, kapaciteti për t'i mobilizuar resurset që janë të nevojshme për zbatimin e planit duhet t'i kalojnë kufijtë e caktuar të komunës dhe të bëhet në kuadër të bashkëpunimit me komunitetet ndërkufitare, duke përfituar nga zhvillimi sinergjik dhe partneriteti me sektorët e tërthortë (shkencor, akademik, OJQ-të, sektori privat, etj.).

Trendët e tanishëm tregojnë për një mungesë të kapacitetit për t'i përfshirë aktorët përkatës në procesin e planifikimit (kryesisht industria e çimentos), vështirësitë në ndërtimin e partneriteteve dhe bindjes aktive të palëve të treta që të marrin pjesë në procesin e rigjallërimit urban që është i nevojshëm. Aktualisht komuna është duke u marrë me çështjet e vështira të ndotjes, derisa në të njëjtën kohë, ballafaqohet e shkallë të lartë të papunësisë. Mundësitë e parapara në këtë zonë janë peizazhi dhe trashëgimia kulturore bashkë me burimet e vlefshme minerare. Këto burime natyrore janë ato të cilat komuna duhet të mundohet t'i sigurojë, forcojë dhe përmirësojë, pasi biodiversiteti dhe tiparet natyrore e karakterizojnë Hanin e Elezit. Disa nga pengesat që duhen vlerësuar më tej janë vështirësia në krijimin e veprimtarive industriale të qëndrueshme, të cilat mund të ndihmojnë në zvogëlimin e shkallës së varfërisë, pa e rrezikuar më shumë peizazhin natyror, dhe në të njëjtën kohë duke u marrë me zhvillimin urban që është i nevojshëm për ta siguruar një mënyrë të shëndetshme të jetesës për popullatën. Zhvillimi i ri i paraparë në Gorancë ngrit disa nivele të shqetësimeve, d.m.th shtimin e varësisë nga veturat, shtimin e kontrastit shoqëror (të shkaktuar nga sektorizimi i zhvillimit të banimit), rrezikimi i trashëgimisë kulturore, vështirësitë në detyrimin që proceset e zhvillimit urban të bëhen me plane cilësore.

Thuhet se Hani i Elezit është i ndërlidhur me zonat fqinje në aspektin shoqëror, ekonomik dhe fizik. Kjo paraqet mundësi sfiduese administrativ edhe territoriale. Derisa PZHK-ja i ka konsideruar çështjet ndërkufitare si një përbërës jetik për zhvillimin e komunës, pranohet se ekzistojnë kufizime në ndikimin e PZHK-së përkitazi me zhvillimin e mundshëm ndërkufitar vendas dhe ndërkombëtar. Po ashtu, është pranuar se mungesa ekzistuese e të dhënave dhe vështirësitë në matjen dhe shprehjen e çështjeve komplekse që dalin nga çështjet ndër-disiplinore dhe ndërkufitare mund të jenë problematike. Prandaj Korniza e VSM-së është hartuar për t'i pasqyruar sfidat dhe mundësitë rajonale në kuadër të Hanit të Elezit, por duke e pranuar faktin se disa nga këto çështje mund t'i devijojnë kufijtë administrativ të Hanit të Elezit gjë që do të kërkojë rritjen e fleksibilitetit në objektiva dhe tregues.

12. Monitorimi

Një aspekt tjetër për shqyrtim është detajzimi i treguesve që duhet monitoruar, me anë të së cilëve mund të vlerësohen performanca mjedisore e planit dhe efektet e planit në mjedis. Instrumenti i Indikatorëve Global të Qytetit (GCIF), i krijuar nga Universiteti i Torontos me përkrahjen e UN-Habitatit përmban një listë kontrolluese të hollësishme të treguesve për vlerësimin e performancës së qytetit.

Propozimi është që t'i bashkohemi kësaj platforme cila ofron një grumbull të caktuar të treguesve të qytetit për krahasueshmërinë globale të performancës së qytetit. Për shkak të natyrës strategjike të PZHK-së, treguesit e synuar për matjen e suksesit dhe përcjelljen e realizimit të planit duhet të caktohen gjithashtu duke e synuar një spektër më të gjerë të çështjeve të qëndrueshmërisë, me rëndësi në nivelin lokal.

GCIF është i ndarë në 22 kategori ku maten një varg i shërbimeve të qytetit dhe faktorët e kushteve jetësor. Kategoritë e shërbimeve të qytetit janë Arsimi, Energjia, Rekreacioni, Shërbimi Zjarrfikës, Qeverisja, Shëndetësia, Shërbimet Sociale, Mbeturinat, Transporti, Planifikimi urban, Ujërat e zeza, Uji. Kategoritë e kushteve të jetesës janë: Angazhimi qytetar, Kultura, Ekonomia, Mjedisi, Strehimi, Barazia sociale, Mirëqenia subjektive, Teknologjia dhe Inovacionet. Në përgjithësi janë identifikuar 26 indikatorë, për të cilët inkurajohen të gjitha qytetet që të raportojnë, si dhe 26 indikatorë tjerë të dëshirueshëm. Tabela 18 e jep listën e të gjithë indikatorëve të caktuar për ta përcjellë performancën.

Këta indikatorë janë përzgjedhur ashtu që të jenë "Në përgjithësi të disponueshëm, aktualë dhe në gjendje që të raportohen në baza vjetore; Të gatshëm për krahasim nëpër qytete; Relevante në vendim-marrjen për politikën publike; E lidhur me qëllimet e përcaktuara (p.sh. QZHK-të, master planet, infrastruktura, planifikimi i investimeve); Racionalë në mbledhjen e tyre; Domethënës për qytetet në tërë botën,

pavarësisht gjeografisë, kulturës, begatisë, madhësisë apo strukturës politike; Fleksibil për përsosje dhe zgjerim me kalimin e kohës; Të kuptueshëm dhe jo shumë të ndërlikuar; dhe të Qartë lidhur me ndryshimet që i nënkupton indikatorit”.

Tabela 18: Indikatorët e përgjithshëm të qytetit
 (Indikatorët themelor të theksuar, indikatorët përcjellës të patheksuar)

KATEGORIA	
1. SHËRBIMET E QYTETIT	
Arsimi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e fëmijëve që e mbarojnë arsimin fillor dhe të mesëm: shkalla e mbijetesës <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e nxënësve që e mbarojnë arsimin fillor ▪ Përqindja e nxënësve që e mbarojnë arsimin e mesëm ▪ Raporti nxënës/mësues ▪ Përqindja e fëmijëve të moshës shkollore të regjistruar në shkolla sipas gjinisë <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e fëmijëve meshkuj të regjistruar në shkolla ▪ Përqindja e fëmijëve femra të regjistruar në shkolla
Zjarrfikësit dhe reagimi i shpejtë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i zjarrfikësve në 100,000 banorë ▪ Numri i vdekjeve të lidhura me zjarrin në 100,000 banorë ▪ Koha e reagimit të zjarrfikësve prej thirrjes së parë
Shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vdekshmëria nën moshën pesë vjeçare në 1,000 lindje të gjalla ▪ Numri i shtretërve në spitale për 100,000 banorë ▪ Numri i mjekëve në 100,000 banorë ▪ Jetëgjatësia mesatare ▪ Numri i personelit të infermierëve dhe mamive në 100,000 banorë
Rekreacioni	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Metrat katror të hapësirës publike rekreative të mbyllur për kokë banori ▪ Metrat katror të hapësirës publike rekreative të hapur për kokë banori
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i vetëvrasjeve në 100,000 banorë ▪ Numri i policëve në 100,000 banorë ▪ Shkalla e krimeve të dhunshme në 100,000 banorë
Mbeturinat e ngurta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit me mbledhje të rregullt të mbeturinave ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që riciklohen ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që digjen në furrë pletrash ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që digjen në ambient të hapur ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që hedhen në deponi të hapur ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që hedhen në deponi sanitare ▪ Përqindja e mbeturinave të qytetit që hedhen në mënyra tjera
Transporti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Km të sistemit publik transit me kapacitet të lartë në 100,000 banorë ▪ Km të sistemit transit të lehtë të udhëtarëve në 100,000 banorë ▪ Numri i automobilave personal për kokë banori ▪ Numri vjetor i udhëtimeve publike transit për kokë banori ▪ Numri i automjeteve motorike me dy rrotë për kokë banori ▪ Lidhjet Ajrore Komerciale (numri i destinacioneve ajrore komerciale pa ndalesa) ▪ Vdekjet në komunikacion në 100,000 banorë
Ujërat e zeza	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit që i largohen mbeturinat ▪ Përqindja ujërave të zeza të qytetit që nuk janë trajtuar fare ▪ Përqindja e ujërave të zeza të qytetit me trajtim primar ▪ Përqindja e ujërave të zeza të qytetit me trajtim sekondar ▪ Përqindja e ujërave të zeza të qytetit me trajtim tretësor

Uji	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit me shërbime të ujësjellësit ▪ Konsumi familjar brendshëm i ujit për kokë banori ▪ Përqindja e popullatës së qytetit me qasje të qëndrueshme në ndonjë burim të përmirësuar të ujit ▪ Konsumi i përgjithshëm i ujit për kokë banori ▪ Përqindja e humbjeve të ujit ▪ Numri mesatar i orëve në vit me ndërprerje të ujësjellësit për ekonomi familjare
Energjia	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit me furnizimi elektrik legal ▪ Shfrytëzimi i përgjithshëm rezidencial i rrymës për kokë banori ▪ Shfrytëzimi i përgjithshëm i rrymës për kokë banori (kilovat/orë) ▪ Numri mesatar i ndërprerjes së rrymës për konsumator në vit ▪ Kohëzgjatja mesatare e ndërprerjeve të rrymës (në orë)
Financat	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkalla e kthimit të borxheve (shpenzimet e kthimit të borxhit si përqindje e të hyrave nga burimet vetanake të komunës) ▪ Taksat e mbledhura si përqindje e taksave të faturuara ▪ Të hyrat nga burimet vetanake si përqindje e të hyrave të përgjithshme ▪ Shpenzimet kapitale si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme
Qeverisja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e femrave të punësuar në personelin e qeverisjes së qytetit
Planifikimi urban	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Raporti vende pune/banesa ▪ Zona e gjelbër (hektarë) në 100,000 banorë ▪ Madhësia e vërtetë e vendbanimeve joformale si përqindje e zonës së qytetit
2. KUSHTET E JETËS	
Angazhimi qytetar	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pjesëmarrja e votuesve (si përqindje e votuesve me të drejtë vote) ▪ Përfaqësimi i qytetarëve: numri i zyrtarëve lokal të zgjedhur në pozitë në 100,000 banorë
Kultura	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e vendeve të punës në sektorin kulturor
Ekonomia	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prodhimi për kokë banori në qytet ▪ Shkalla e papunësisë në qytet ▪ Përqindja e personave në punësim me orar të plotë
Mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koncentrimi i PM10 ▪ Emetimet e gazrave të serës në ton për kokë banori
Strehimi	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit që jetojnë në lagje të varfra ▪ Numri i ekonomive familjare që ekzistojnë pa fleta poseduese ▪ Numri i të pastrehëve në 100,000 banorë
Barazia sociale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përqindja e popullatës së qytetit që jeton në varfëri
Mirëqenia subjektive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Indeksi i mirëqenies subjektive
Teknologjia dhe inovacionet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Numri i lidhjeve të internetit në 100,000 banorë ▪ Numri i patentave të reja në 100,000 për një vit ▪ Numri i diplomave të arsimit të lartë në 100,000 banorë ▪ Numri i telefonave (fiks dhe mobil) në 100,000 banorë ▪ Numri i lidhjeve të telefonisë fikse në qytet ▪ Numri i lidhjeve të telefonisë mobile në qytet

13 Pjesëmarrja publike dhe hapat e ardhshëm

Rregulloret e VSM-së parashohin që të ftohen organet konsultative, publiku dhe ndonjë aktor tjetër përkatës për t'i shprehur mendimet e tyre lidhur me raportin e VSM-së, ashtu që të ndihmojnë të sigurohemi se janë identifikuar të gjitha çështjet e rëndësishme të mjedisit. Për këtë edhe është përgatitur pyetësori i mëposhtëm.

Pyetjet për të konsultuarit

Q1: A ekzistojnë politika, plane ose programe tjera që përmbajnë objektiva për mbrojtjen e mjedisit ose që identifikojnë çështje të cilat nuk janë të përfshira në këtë vlerësim?

Q2: A ka ndonjë çështje ose informata tjera të ndërlidhura me temat e mbuluara në pjesën 4.2 që janë relevante për planin zhvillimor të Hanit të Elezit dhe që duhet të përfshihen?

Q3: A ekziston ndonjë ndërlidhje tjetër potenciale, efekte kumulative ose sinergjike që duhet të shqyrtohen më hollësisht?

Q4: A ekzistojnë probleme tjera, mundësi ose çështje tjera që janë relevante për planin zhvillimor të Hanit të Elezit e që nuk janë përfshirë?

Q5: Ku mendoni se janë çështjet kryesore në këtë zonë dhe cilat tema dëshironi të adresohen me prioritet në VSM?

Q6: A ofrojnë objektivat, kriteret dhe indikatorët e VSM-së një kornizë të arsyeshme nëpërmjet të cilës mund të vlerësohen efektet e mundshme mjedisore të rëndësishme të dokumenteve të planit zhvillimor?

Q7: A ekzistojnë përplasje tjera të mundshme ndërmjet objektivave të propozuara të VSM-së dhe objektivave themelore të strategjisë që nuk janë identifikuar në vlerësimin e përputhshmërisë?

Q8: Si mund të adresohen përplasjet potenciale?

Q9: Si do të dëshironite organizata juaj të përfshihej në pjesën tjetër të procesit të VSM-së?

Q10: A besoni se ndikimet e rëndësishme të planit zhvillimor mund të identifikohen duke e shfrytëzuar këtë qasje?

Q11: A ekzistojnë metodologji tjera shtesë që mund të shfrytëzohen për t'i identifikuar ndikimet e rëndësishme të strategjive themelore?

Përgjigjet tuaja ju lutemi dërgoni te:

Pas periudhës konsultative dhe shqyrtimit të gjitha mendimeve të shprehura nga organet konsultative, publiku dhe aktorët përkatës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet ta rishikojë raportin e VSM-së. Sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L –230 të vitit 2010, autoriteti përgjegjës (në këtë rast Komuna e Hanit të Elezit) duhet ta marrin parasysh raportin e VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve duke i përfshirë konsultimet ndërkufitare gjatë përgatitjes së planit para miratimit të tij.

14. Fjalorthi

Këtu i paraqesim përkufizimet e disa prej shprehjeve kryesore që janë përdorur në raportin e këtij Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

Ndikimet kumulative: ndikimet e shkaktuara nga disa projekte dhe veprime strategjike që dalin nga ndonjë veprim i propozuar.

Vlerësimi mjedisor: Metoda ose procedura për vlerësimin e mjedisit. Në Direktivën e VSM-së (Neni 2(b)), vlerësim mjedisor do të thotë "përgatitja e raportit mjedisor, kryerja e konsultimeve, marrja parasysh e raportit mjedisor dhe rezultateve të konsultimeve në vendim-marrje dhe sigurimin e ofrimit të informatave për vendimin.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis: Procesi i shqyrtimit të pasojave mjedisore të projekteve zhvillimore përpara vendim-marrjes. Dallon nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor në kuptimin se ai në përgjithësi i referohet efekteve më specifike që dalin nga zbatimi i projektit në nivelin lokal, ndërsa shumë vendime negative për mjedisin tashmë janë marrë në një nivel strategjik më të gjerë (për shembull fakti se infrastruktura e re e transportit mund të krijojë kërkesë të shtuar për udhëtim). Fazat e një VNM-je përfshijnë:

- vendimin nëse VNM është i nevojshëm ("analizimi")
- vendimi se cilat ndikime dhe çështje duhet të adresohen ("shkoqitja")
- përshkrimi i projektit të propozuar dhe alternativave
- përshkrimi i standardit bazë të mjedisit
- parashikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të projektit në standardin bazë
- propozimi i masave për të zbutur ndonjë prej ndikimeve negative të rëndësishme (si dhe për t'i rritur më tej ndikimet pozitive)
- raportimi i konkluzioneve në një deklaratë për ndikimin në mjedis
- përfshirja e publikut dhe aktorëve tjerë të interesuar/prekur në faza të ndryshme të VNM-së.

Indikator/tregues: Një informatë, në përgjithësi sasiore, e cila përdoret për të matur dhe përcjellë gjendjen aktuale dhe progresin e një sistemi kompleks. Në kuadër të VSM-së, indikatorët shpesh përdoren për matjen e nivelit të suksesit të një plani ose projekti dhe për arritjen e objektivave.

Ndikimet e tërthorta: Ndikimet që mund të përnixten nga një projekt apo veprim strategjik, për shembull zhvillimi i cili bëhet rreth udhëkryqeve të autostradës pasi të jetë ndërtuar ajo. Po ashtu quhen ndikime të gjeneruara apo të përnxitura.

Masat për zbutje: Masat që i shmangin, zvogëlojnë, përmirësojnë dhe kompensojnë ndikimet e mëdha të dëmshme të ndonjë veprimi strategjik në mjedis.

OJQ: Organizatë jo-qeveritare (p.sh. shoqatat qytetare, unioni i bujqve) të themeluara në mënyrë ligjore nga subjektet fizike ose juridike që funksionojnë të pavarur nga cilado qeveri.

Objektivi: Synimi i veprimit strategjik ose VSM-së, që e përkufizon atë që mundohet të arrijë, drejtimi i dëshiruar i ndryshimit ose përmirësimit të trendëve aktual.

Plani: Procedura e formalizuar, që i përcakton objektivat e bashkërenduar dhe të matur në kohë për zbatimin e një politike.

PM10: Grimcat e imëta që kalojnë nëpër grykën me madhësi të paracaktuar siç përkufizohet në metodën referente për mostrat dhe matjen e PM10, EN 12341, me ndalim efikas prej 50 % në diametrin aerodinamik prej 10 µm. Disa grimca paraqiten natyrshëm, që burojnë nga vullkanet, stuhitë e pluhurit, pyjet dhe zjarret e fushave me bar dhe nga burimet tjera. Veprimtaritë njerëzore, si djegia e karburanteve nga fosilet në automjete, termocentralet dhe veprimtaritë e ndryshme industriale, po ashtu prodhojnë nivele të ngritura të grimcave të imëta në ajër të cilat lidhen me dëmtimet e shëndetit si sëmundjet e zemrës, dëmtimi i funksionimit të mushkërive dhe kanceri i mushkërive.

Shkoqitja: Procesi i vendosjes së përmbajtjes dhe nivelit të hollësive në VSM (llojet e efekteve në mjedis, alternativat që duhen shqyrtuar) dhe si duhet të kryhet VSM-ja (afati kohor, metodologjia, struktura e raportit, etj). Ky proces duhet të kryhet herët, mundësisht në konsultim me autoritetin kompetent dhe grupet e prekura.

Raporti i VSM: Raporti i kërkuar nga Direktive për VSM-në si pjesë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili i identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet e rëndësishme të mundshme në mjedis nga realizimi i një Vlerësimi strategjik mjedisor për Propozim planin zhvillimor komunal të Hanit të Elezit |

plani ose programi. Ky dokument duhet ta regjistrojë procesin dhe konkluzionet e procesit të VSM-së. Po ashtu quhet edhe raport mjedisor.

Aktor: Dikush që ndikohet nga veprimet strategjike: ata kanë interes në to.

Veprim strategjik: A Vendimi që është "përmbi" nivelin e projektit: politika, plani ose programi.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (SEA): Vlerësimi mjedisor i aplikuar ndaj politikave, planeve dhe programeve që kërkon një proces të parashikimit dhe vlerësimit të ndikimit të veprimeve strategjike në mjedis. Informatat që dalin nga VSM-ja është paraparë që të shfrytëzohet në vendim-marrje. Po ashtu njihet si vlerësim i qëndrueshmërisë, vlerësimit mjedisor, vlerësimit sektorial, vlerësimit të ndikimeve programatike mjedisore. Në këtë raport, VSM është shfrytëzuar për ta përmendur llojin e vlerësimit mjedisor që kërkohet me anë të Direktivës dhe Ligjit të Kosovës për VSM-në.

Direktiva për VSM-në: Direktiva Evropiane 2001/42/EC "për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis".

Vlerësimi i qëndrueshmërisë: VSM-ja që i shqyrton çështjet ekonomike dhe shoqërore si dhe mjedisore.

15. Literatura

- Agência Portuguesa do Ambiente, *Guia de boas práticas para a Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas*, Lisbon, Direcção-Geral do Ordenamento do Território e Desenvolvimento Urbano, 2007
- ANDRÉ, Pierre et al, *Public participation: international best practice principles, Special Publication Series No. 4*, Fargo, USA, International Association for Impact Assessment, 2006
- BERGERHOFF, Joachim, *Environmental Assessment methodology*, UN-Habitat Municipal Spatial Planning Support Program in Kosovo, 2010 [memo]
- CALTHORPE, Peter, *Urbanism in the age of climate change*, Washington, Island Press, 2010
- European Commission, *Eurostat regional yearbook 2010*, Luxembourg, Publications Office of the European Union, 2010
- European Commission, *Implementation of Directive 2001/42/EC on the Assessment of the Effects of Certain Plans and Programmes on the Environment*, Brussels, 2003
- European Commission, *European Spatial Development Perspective: Towards Balanced and Sustainable Development of the Territory of the European Union*, Brussels, 1999
- GEHL, Jan, *Cities for people*, Washington | Covelo | London, Island Press, 2010
- Global city indicators facility*, Toronto, University of Toronto, 2010 [report]
- GOODLAND, Robert and Jeff ANHANG, "Livestock and Climate Change", *World Watch Magazine*, November-December 2009, pp. 10-19
- Hani i Elezit Municipality, *Municipal Development Plan – Draft document V2*, HiEM, 2010
- International Association for Impact Assessment, *Vlerësimi Strategjik Mjedisor: Performance Criteria*, Fargo, IAIA, 2002
- Office of the Deputy Prime-Minister, *A Practical Guide to the Vlerësimi Strategjik Mjedisor Directive*, London, ODPM Publications, 2005
- PARTIDÁRIO, Maria do Rosário, *Guia de Boas Práticas para Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas*, Lisbon, Agência Portuguesa do Ambiente, 2007
- PINHEIRO, Manuel Duarte, *Ambiente e construção sustentável*, Amadora, Instituto do Ambiente, 2006
- Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, *EIA training resource manual for South Eastern Europe*, Szentendre, REC, 2003
- UN-HABITAT, *State of the World's Cities: Cities for All, bridging the urban divide*, London, Earthscan, 2010
- World Business Council for Sustainable Development, *Cement Technology roadmap: carbon emission reductions up to 2050*, Paris, International Energy Agency, 2009
- The Worldwatch Institute, *State of the World 2010: Transforming cultures, from consumerism to sustainability*, London, Earthscan, 2010
- The Worldwatch Institute, *Vision for a sustainable world: Green economy program*, 2010a. Accessed January 11 2011, http://www.worldwatch.org/programs/global_economy